




# ARGUMENTUM

news opinion analysis



**KINA 2026-2030**  
**MOTOR I ZHVILLIMIT DHE**  
**FUQISË SË INOVACIONIT**

## Pse Plani i 15-të Pesëvjeçar i Kinës ka rëndësi për Shqipërinë dhe botën

Editorial

Në fund të tetorit të vitit 2025, Kina publikoi rekomandimet për hartimin e Planit të 15-të Pesëvjeçar, duke tërhequr vëmendjen e botës drejt Pekinit. Ky dokument strategjik nuk është thjesht një plan zhvillimi ekonomik për një vend me mbi 1.4 miliardë banorë, por ai pasqyron orientimet globale dhe fuqinë e lëvizjeve gjeopolitike dhe ekonomike që do të formësojnë dekadat e ardhshme.

Plani i 15-të Pesëvjeçar përshkruan strategjinë e Kinës për rritje me cilësi të lartë, duke u fokusuar në përmirësimin industrial, vetëmbështetjen teknologjike, rritjen e kërkesës së brendshme dhe hapjen e jashtme, ndër prioritetet e tjera. Ky plan vjen në një moment vendimtar, ndërsa Kina përfundon tranzicionin drejt një ekonomie të përparuar dhe të udhëhequr nga inovacioni, forcon mirëqenien sociale dhe standardet e jetesës, dhe thëllon reformat strukturore për të mbështetur rritjen e qëndrueshme dhe të ekuilibruar.

Në këtë Edicion Special, ekspertë shqiptarë dhe kineze shpjegojnë se si inovacioni, zhvillimi i qëndrueshëm dhe prioritetet sociale të Pekinit mund të kenë ndikim edhe jashtë Kinës. Kina nuk është më vetëm “fabrika e botës” – ajo është motor ekonomik dhe financiar që influencon tregjet globale, zinxhirët e furnizimit dhe investimet ndërkombëtare.

Ky Plan Pesëvjeçar është gjithashtu një pasqyrë e orientimeve politike dhe gjeostrategjike të Kinës, duke pasqyruar rolin e saj në një botë ku tensionet dhe rivalitetet globale po rriten. Për Shqipërinë dhe Ballkanin, ku pozicioni gjeopolitik është gjithmonë i ndërlikuar, kuptimi i këtyre dinamikave është esencial për të planifikuar marrëdhënie ekonomike, partneritete strategjike dhe politika të qëndrueshme zhvillimi.

Ky numër special i Revistes ARGUMENTUM synon të sjellë lexuesin shqiptar më afër këtyre analizave të thelluara, duke shpjeguar sesi një vend kaq i madh dhe kaq larg mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë dhe indirekt mbi ekonominë, teknologjinë dhe jetën tonë të përditshme. Duke e lexuar këtë numër, do të kuptoni se Plani i 15-të Pesëvjeçar i Kinës është një udhërrëfyes për të gjithë botën, për të gjithë ne.

Plani i 15-të Pesëvjeçar i Kinës ofron një vizion të qartë për drejtimin e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik në vitet e ardhshme. Ai dëshmon se edhe në kohë sfidash globale mund të krijohen mundësi të reja për inovacion, bashkëpunim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, edhe Shqipëria, ashtu si pjesa tjetër e botës, duhet ta vlerësojë këtë strategji si një drejtim të rëndësishëm për zhvillimin e së ardhmes.

**Marjana DODA**

*Kryeredaktore, Argumentum.al*

## Përmbajtja

1. Kina dhe ndikimi i saj në ekonominë globale

**Prof. Dr. Enver BYTYÇI**

2. Kina drejt risive teknologjike moderne

**Dr. Jorgji KOTE**

3. Plani i 15-të Pesëvjeçar ofron një të ardhme

të qëndrueshme për bashkëpunimin Kinë-BE

**Dr. JIN Ling**

4. Plani i 15-të pesëvjeçar i Kinës dhe strategjia

e hapjes ndaj botës së jashtme

**Redion LULI**

5. Nga Toka te Teknologjia: Transformimi Rural në

Kinën Moderne

**Etleva XHAJANKA**

6. Strategjia e Kinës për mirëqenie dhe prosperitetit

të përbashkët

**Dr. Marsela MUSABELLIU**

7. Mundësitë i tejkalojnë sfidat në bashkëpunimin e

gjelbër Kinë-BE

**Prof. YANG Danping dhe Prof. Dr. KONG Tianping**

8. Kina, Zhvillimi i Gjelbër dhe Disa Mësime për

Shqipërinë

**Alqi KOÇIKO**

# KINA DHE NDIKIMI I SAJ NË EKONOMINË GLOBALE



Një pamje e Sallës së Madhe të Popullit nga Sheshi Tiananmen në Pekin, shtator 2025./ Foto nga VCG

Prof. Dr. Enver Bytyçi

**K**ina ka transformuar ekonominë e saj në një fuqi globale të pakonkurreshme. Qetësia dhe strategjia e saj ndaj presioneve ndërkombëtare kanë tërhequr vëmendjen e botës. Plani i 15-të pesëvjeçar forcon rolin e Kinës në ekonominë globale dhe në tregjet ndërkombëtare

Presidenti i Republikës Popullore të Kinës Xi Jinping është i vetmi lider në glob që nuk shprehu shqetësim sa i përket tarifave doganore e tregtare të presidentit amerikan, Donald Trump. Megjithatë, ai dha edhe mesazhe të qarta se Kina është e aftë të zhvillohet dhe përballojë me sukses

sfidat e kohës. Ndërkohë, në një telefonatë të fillimit të shkurtit me homologun e tij amerikan, presidenti kinez foli për respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim të barabartë. Ai thoshte se Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dy vendet më të mëdha do të lëvizin në respekt të njëra-tjetrës dhe në një bashkëpunim koekzistent të barabartë?! Ndërsa, Trump thoshte pas kësaj bisede se ajo ishte ekselente. Xi përmes kësaj deklarate dha mesazhin se Republika Popullore e Kinës është e përkushtuar ndaj kursit të paqes dhe harmonisë midis shteteve, sidomos të Fuqive të Mëdha. Kina nuk është xhelozë e as armiqësore me të tjerët, përfshirë dhe amerikanët. Kursi i saj politik e diplomatik

është marrëveshja, bashkëpunimi, respekti i ndërsjellë dhe përparimi global.

Kjo harmoni në qëndrimet kineze shprehet gjithashtu në planet e zhvillimit të saj. Plani i ri pesëvjeçar nuk përmend vështirësi në marrëdhëniet me shtetet e Fuqitë e tjera të Globit. Nuk parashikon vështirësi në marrëdhëniet e Kinës me asnjë prej vendeve në Azi, Europë ose Amerikë apo gjetkë. Është një plan që bazohet në resurset e vetë Kinës për zhvillim e përparim të vazhdueshëm.

E gjitha kjo ndodh për shkak të zhvillimit ekonomik, në teknologji dhe Inteligjencën Artificiale të saj. Për shumë vite, Kina ka ndjekur një kurs politik, ekonomik e tregtar në sulm, sa

*Dy karakteristikat themelore të zhvillimeve të sotme dhe atyre që parashikohen në vitet e ardhshme janë civilizimi dhe modernizimi kinez. Dhe nëse Kina do të vazhdojë të ruajë ritmet e sotme të zhvillimit dhe rritjes ekonomike, të mirëqenies e teknologjisë, atëherë ajo me shumë mundësi do ta realizojë objektivin e saj për të qenë një vend me civilizim dhe modernizim të qëndrueshëm.*



Një robot vrapon përkrah njerëzve në Gjysmëmara-tonën Yizhuang të Pekinit dhe Gjysmëmara-tonën e Robotëve Humanoide në Pekin, 19 prill 2025./ Foto nga VCG



i përket shtrirjes dhe thellimit të zhvillimeve industriale, teknologjike, energjetike dhe sektorë të tjerë. Është i vetmi vend në glob me 1.4 miliard banorë, që ka ndryshuar ekuilibrat në raportet ekonomike me botën, si dhe në luftën kundër varfërisë dhe ka aplikuar teknologjinë më të lartë në shërbimet publike. Vendi është i hapur sipas parimeve të ekonomisë së tregut me tregun ndërkombëtar. Sot SHBA-të dhe vendet e tjera të industrializuara, aq sa janë Fuqitë ekonomike të botës ndjejnë nevojën e domosdoshme për bashkëpunim me Kinën.

Dy karakteristikat themelore të zhvillimeve të sotme dhe atyre që parashikohen në vitet e ardhshme janë civilizimi dhe modernizimi kinez. Dhe nëse Kina do të vazhdojë të ruajë ritmet e sotme të zhvillimit dhe rritjes ekonomike, të mirëqenies e te-

knologjisë, atëherë ajo me shumë mundësi do ta realizojë objektivin e saj për të qenë një vend me civilizim dhe modernizim të qëndrueshëm.

Thjesht disa shifra të asaj çfarë është arritur deri më sot janë këto:

Nga viti 1980 e deri më sot Republika Popullore e Kinës ka shënuar çdo vit rritje të konsiderueshme të produktit të përgjithshëm bruto. Nga viti 1991 e deri

në vitin 2018 rritja e këtij produkti ka shënuar mesatarisht 9-10 përqind. Pas goditjes së Covid-19, Kina shënoi sërishmi ritme rritjeje si në vitet e mëparshme. Dhe nga ana tjetër duhet thënë se si rezultat i politikave ekonomike të zhvillimit, Republika Popullore e Kinës nuk u përfshi në krizat e ekonomive të mëdha në botë gjatë viteve 2007-2011. Ndikimet e kësaj krize ishin minimale. Qëndrueshmëria ekono-



**Kur Kina u pranua në Organizatën Botërore të Tregtisë, më 2001, ajo prodhonte vetëm 7 përqind të Produktit të Përgjithshëm Shoqëror të botës. Në vitin 2025 prodhoi 20 përqind të këtij produkti. Ndërkohë tërheq vëmendjen në zhvillimin e gjigandit kinez ajo që lidhet me strukturën e zhvillimit. Balanca është impresionuese. Në strukturën e ekonomisë kineze zënë vend të gjithë sektorët dhe degët, bujqësia, industria, teknologjia, energjetika, transporti, ndërtimi etj.**



Pamje e vendit të ndërtimit të projektit të Autostradës Zhengzhou-LuoYang, në qytetin Luoyang, Provinca Henan e Kinës, shtator 2025. / Foto nga VCG

mike dhe zhvillimi teknologjik vazhduan në këtë vend gjatë gjithë periudhës. Në rankingun botëror Kina është që prej vitit 2010 vendi i dytë në botë sa i përket GDP-së. Dhe prej atij viti rritet vazhdimisht. Në vitin 2025 Produkti i Përgjithshëm Shoqëror ishte në SHBA 30,6 trilionë dollarë, në Kinë 19,4 trilionë, në Gjermani 5,0 trilionë dhe në Japoni 4,2 trilionë dollarë amerikanë. Këto janë edhe katër vendet me GDP-në më të lartë në botë.

Kur Kina u pranua në Organizatën Botërore të Tregtisë, më 2001, ajo prodhonte vetëm 7 përqind të Produktit të Përgjithshëm Shoqëror të botës. Në vitin 2025 prodhoi 20 përqind të këtij produkti. Ndërkohë tërheq vëmendjen në zhvillimin e gjigandit kinez ajo që lidhet me strukturën e zhvillimit. Balanca është impresionuese. Në strukturën e ekonomisë kineze zënë vend të gjithë sektorët dhe degët, bujqësia, industria, teknologjia, energjetika, trans-

porti, ndërtimi etj. Kina është tashmë një vend i zhvilluar industrial. Ajo zë plot 1/3 në zhvillimin e përgjithshëm të vendit, 33,1 përqind. Po t'i shtojmë teknologjinë e lartë të kësaj industrie, atëherë merret me mend se sa i fuqishëm është ky vend në raport me pjesën tjetër të botës. Dinamika e zhvillimit ekonomik prej vitit 2010 e deri më sot është impresionuese. Është tashmë fakt i pranuar gjerësisht që Kina përbën surprizën më të madhe të zhvillimit ekonomik, industrial, bujqësor, energjetik dhe teknologjik në botë.

Gjithçka ka ndodhur ka një shkak të vetëm – reformat e hapjes me ekonominë globale, respektimi i rregullave dhe ligjeve të ekonomisë së tregut global, qasja e ekuilibruar dhe e balancuar në tregjet e huaja. Por jo vetëm kaq. Karakteristika themelore është durimi dhe përkushtimi për zhvillim, si dhe shfrytëzimi i resurseve që ajo ka. Të gjitha

**Në strukturën e ekonomisë kineze zënë vend të gjithë sektorët dhe degët, bujqësia, industria, teknologjia, energjetika, transporti, ndërtimi etj. Kina është tashmë një vend i zhvilluar industrial. Ajo zë plot 1/3 në zhvillimin e përgjithshëm të vendit, 33,1 përqind. Po t'i shtojmë teknologjinë e lartë të kësaj industrie, atëherë merret me mend se sa i fuqishëm është ky vend në raport me pjesën tjetër të botës. Dinamika e zhvillimit ekonomik prej vitit 2010 e deri më sot është impresionuese.**



Ndërtesa e terminalit të Aeroportit Ndërkombëtar të Pekinit shihet në të njëjtën kornizë me horizontin e qendrës qendrore të qytetit, Pekin, shtator 2025. / Foto nga VCG

këto e kanë shndërruar Kinën në një superfuqi në fushën e ekonomisë, tregtisë, investimeve jashtë dhe brenda vendit, si dhe në teknologji.

Në vijim të këtyre shifrave, edhe plani i 15-të pesëvjeçar i Kinës (2026–2030) parashikon një zhvillim të fokusuar në inovacion, teknologji të lartë, energji të rinovueshme dhe industrinë e gjelbër, duke e pozicionuar vendin si një motor kyç i rritjes ekonomike globale. Ky plan synon të zgjerojë edhe më tej rrjetin e bashkëpunimeve ndërkombëtare, përfshirë investime dhe tregti me Europën dhe Ballkanin, ku Shqipëria mund të përfitojë nga mundësi të reja në fushat e energjisë, infrastrukturës dhe teknologjisë. Strategjia kineze për bashkëpunim ekonomik bazohet në ndërtimin e lidhjeve të qëndrueshme dhe reciproke, duke ofruar investime direkte, pro-


jekte infrastrukturore dhe partneritete teknologjike që mund të përshpejtojnë zhvillimin ekonomik në vendet partnere. Për Europën, kjo nënkupton një mundësi për diversifikimin e tregtisë dhe investimeve, duke u lidhur me një nga ekonomitë më dinamike të botës. Në një perspektivë globale, zbatimi i këtij plani pritet të rrisë ndikimin e Kinës në ekonominë botërore, duke e bërë atë një partner të domosdoshëm për vendet e G7-ës dhe një aktor kyç në vendimmarrjet për tregtinë, teknologjinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë globale.

Tashmë Kina është aq e fuqishme dhe me ndikim aq të fortë në ekonominë botërore, sa asnjë vend nuk mundet ta detyrojë të veprojë nën diktatin e tij, shkruante para pak kohësh revista britanike “The Economist”!

Në përfundim, Republika Pop-

ullore e Kinës nuk është më vetëm një ekonomi në rritje, por një aktor strategjik global me ndikim të thellë në tregjet, teknologjinë dhe investimet ndërkombëtare. Me Planin e 15-të pesëvjeçar, Kina synon të forcojë pozicionin e saj si motor i inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke krijuar mundësi bashkëpunimi edhe për vendet e Evropës dhe Ballkanit, përfshirë Shqipërinë. Në këtë mënyrë, Kina nuk garanton vetëm stabilitet dhe rritje brenda vendit, por edhe një ekuilibër të ri në ekonominë botërore, duke u shndërruar në një partner të domosdoshëm për çdo vend që kërkon të integrohet në rrjetin e avancuar global të tregtisë, teknologjisë dhe investimeve. Qëndrueshmëria, inovacioni dhe vizioni i Kinës e bëjnë atë jo vetëm një superfuqi ekonomike, por edhe një model të mundshëm për zhvillimin e qëndrueshëm në shekullin XXI.

# KINA DREJT RISIVE TEKNOLOGJIKE MODERNE



Një ilustrim i robotëve të inteligjencës artificiale. /Foto nga CMG

Dr. Jorgji Kote

Mjeshtër i Madh në Diplomaci

Viti 2026 shënoi për Republikën Popullore të Kinës fillimin e zbatimit të Planit të 15-të Pesëvjeçar 2026-2030. Një moment historik, mbasi falë këtij Plani, ajo do të shënojë hope dhe përparime cilësore në të gjitha frontet drejt realizimit të synimit strategjik për modernizimin socialist deri më 2035.

Parimet dhe piketat kryesore të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit për Planin e 15 -të Pesëvjeçar janë pasqyruar në Rekomandimet e Plenumit të 4-t të KQ të PKK-së të mbajtur në Pekin më 20 – 24 Tetor 2025. Ai do të kthehet në Ligj themeltar

me miratimin e tij në Kongresin Kombëtar të Popullit në Mars 2026.

Në kuadrin e modernizimit me përparësi të ekonomisë, ky Plan përmban objektiva themelore për përparim të hovshëm në fushën

e shkencës dhe inovacionit teknologjik si dhe në zhvillimin e forcave të reja me rendiment të lartë. Për rrjedhojë, Kina pritet të ketë edhe tregues shumë më të lartë cilësorë socialë, duke bërë hapa të mëdhenj përpara

**Në vitin 2025 Kina u ndesh me disa sfida serioze strukturore për shkak edhe të modelit të rritjes ekonomike të vendit, i cili mbështetet kryesisht mbi eksportet. Mirëpo, shtrenjtimi i kostove të prodhimit dhe rreziqet gjeopolitike, sidomos konflikti për tarifatat me SHBA-të kanë krijuar pengesa dhe rreziqe serioze për këtë model, i cili gjithsesi do të vazhdojë të ketë përparësi.**



Një central energjie diellor në fusha./ Foto nga VCG

në zbatimin e Nismës madhore “Kina e Bukur”, etj.

Ashtu siç pohojnë ekspertë të njohur ndërkombëtarë, këtu nuk bëhet fjalë për slogane dhe retorika politike, ca më pak për propagandë, por për një Plan real dhe thellësisht reformues, i mbështetur në një bazë të konsoliduar gjatë pesë viteve të kaluara dhe në mundësitë e reja të mëdha që çelen në të ardhmen e afërt.

Në fakt, këto vitet e fundit Kina ka shënuar arritje mbresëlënëse në fushat e shkencës dhe novacionit teknologjik. Kështu, shpenzimet për kërkim-zhvillim në vitin 2024 kapën shifrën 507.6 Miliard Dollarë amerikanë, me një rritje 48 për qind kundrejt vitit 2020. Lidhur me kapacitetet novatore, nga e 14-ta në vitin 2020, në vitin 2024 Kina u rendit e 10-ta në botë. Edhe niveli i integritit teknologjik gjatë të njëjtës periudhe ishte 42 për qind më i lartë. Në Rekomandimet mbi Planin e lartpërmendur nënvizohet se promovimi i risive teknologjike është domosdoshmëri imperative

historike që buron nga kërkesat e brendshme ekonomike, sociale, të mbrojtjes, sigurisë, etj.


Kështu, vitin e kaluar Kina u ndesh me disa sfida serioze strukturore për shkak edhe të modelit të rritjes ekonomike të vendit, i cili mbështetet kryesisht mbi eksportet. Mirëpo, shtrenjtimi i

kostove të prodhimit dhe rreziqet gjeopolitike, sidomos konflikti për tarifatat me SHBA-të kanë krijuar pengesa dhe rreziqe serioze për këtë model, i cili gjithsesi do të vazhdojë të ketë përparësi.

Këto sfida dhe kërkesa të reja epokale bëjnë që Kina t'i kushtojë përparësi shumë më të madhe risive teknologjike në të 12 fushat që përmenden në Rekomandimet në fjalë; ku Kina vjen me një bazë premtuese, si lider botëror në teknologjinë digjitale, energjitike dhe atë industriale.

Duke iu referuar edhe deklaratave për median të Ministrit të Shkencës dhe Teknologjisë të Kinës, Yin Hejun më 24 Tetor 2025, gjatë viteve 2026 – 2030 do në këtë fushë jetike për Kinën por jo vetëm do të realizohen disa reforma themelore. Përpjekjet kryesore do të përqendrohen në përpunimin e materialeve të teknologjisë së lartë - aliazhe dhe gjysëmperçuesat, reaktorët bërthamorë, teknologjia satelitore dhe hapësinore, fotovoltaike, automjetet elektrikë, fabrikat

**Vitet e fundit Kina ka shënuar arritje mbresëlënëse në fushat e shkencës dhe novacionit teknologjik. Kështu, shpenzimet për kërkim-zhvillim në vitin 2024 kapën shifrën 507.6 Miliard Dollarë amerikanë, me një rritje 48 për qind kundrejt vitit 2020. Lidhur me kapacitetet novatore, nga e 14-ta në vitin 2020, në vitin 2024 Kina u rendit e 10-ta në botë. Edhe niveli i integritit teknologjik gjatë të njëjtës periudhe ishte 42 për qind më i lartë.**



Një punëtor në punishten e mbushjes së elektroliteve të një kompanie baterish litium-jon me guaskë çeliku të vogël në Anhui, Kinë Lindore, nëntor 2025. /Foto nga VCG

“smart”, teknologjitë mobile dhe të shëndetit, ku ndonëse disi më mbrapa, sërish rritja e prodhimit vendas është dinamike. Më konkretisht, ndër shembujt e shumtë në këto fusha përmendet njoft-

imi mbi vënien në funksionim në vitin 2030 i fabrikës së parë pa njeri për prodhimin me robotë të automobilave, çka përgjysmon kostot e prodhimit.

Ndërkohë, industritë tradicionale të çeliqueve dhe kimikateve do të modernizohen nëpërmjet transformimit digjital, automatizimit dhe standardeve mjedisore.

Gjithashtu do të motivohen “industri të reja shtyllë”, duke përfshirë aerohapësirën, materiale të reja, energjinë e pastër dhe prodhimi inteligjent. Shteti do t’i mbështesë këto industri me stimuj fiskalë, fonde më të mëdha për kërkim – zhvillim dhe nëpërmjet bashkërendimit të politikave industriale.

Në vijim, do të vazhdojnë përpjekjet për të modernizuar një grup industrish të reja në fushën e teknologjisë së informacionit të gjeneratës së re, me synimin që Kina të vihet në krye të industrisë në fushat e teknologjisë kuantum

dhe bioteknologjisë.


Për të konsoliduar themelet e këtij aspekti madhor, rëndësi e veçantë do t’i kushtohet edhe forcimit të mëtejshëm të rolit të ndërmarrjeve. Thelbësore për këtë do të jetë mbështetja e ndërmarrjeve të mëdha, të vogla e të mesme të teknologjisë së lartë, shtimi i shpenzimeve për kërkim/zhvillim, etj. Kjo merr rëndësi edhe më të madhe kur mendon se në fund të vitit 2024 në Kinë numëroheshin mbi 4500 ndërmarrje të angazhuara me IA-në.

Gjithashtu, shteti do të bëjë investime të mëdha në veprimtarinë kërkimore dhe do të inkurajojë novacionin në sektorin privat, duke shtuar laboratorët dhe panelet teknologjike. Këtij qëllimi do t’i shërbejë edhe integrimi i plotë i arsimit dhe kërkimit shkencor. Universitetet do të shtojnë bashkëpunimin me bizneset për të promovuar talente dhe zbulime të reja shkencore.

Përpjekjet të tjera më të mëdha për inovacion dhe risi teknologjike do të përqendrohen në fusha kyçe si qarqet e integruara, makineri industriale dhe instrumente të cilësisë së lartë, në teknologjitë bazë - gjysëmpërçuesat, bioprodhimi dhe në teknologjitë e IA-së, duke shtuar modelet e reja të algoritmeve, të dhënave dhe çipeve të fjalës së fundit. Që kjo ka filluar qysh tani, mjafton të përmendim se, siç është bërë e ditur edhe në median ndërkombëtare ditët e fundit, laboratorit i specializuar ‘Vuhan’ në Shangaj ka prodhuar çipe kompjuterike me fibër sa një fije floku, të cilat i rezistojnë një ngarkese 15,6 ton dhe mund të mbajnë 100.000 tranzitorë për centimetër.

Këto zhvillime dhe risi teknologjike ofrojnë mundësi të mëdha

**Vitet e fundit Kina ka shënuar arritje mbresëlënëse në fushat e shkencës dhe novacionit teknologjik. Kështu, shpenzimet për kërkim-zhvillim në vitin 2024 kapën shifrën 507.6 Miliard Dollarë amerikanë, me një rritje 48 për qind kundrejt vitit 2020. Lidhur me kapacitetet novatore, nga e 14-ta në vitin 2020, në vitin 2024 Kina u rendit e 10-ta në botë. Edhe niveli i integritit teknologjik gjatë të njëjtës periudhe ishte 42 për qind më i lartë.**



Ky imazh i kapur në Qendrën e Kontrollit Hapësinor të Pekinit tregon një foto në grup të ekuipazhit të anijeve kozmike me pilot Shenzhou-19 dhe Shenzhou-20.

edhe për kompanitë e huaja. Sipas Pingwen Hu, Partner i Lartë dhe Kontabilist Publik në ECOVIS, në Shanghai “në pozita më të favorshme do të jenë kompanitë që do ta vlerësojnë Kinën më shumë si partnere strategjike afat-gjatë se sa si treg i madh”

Në vijim, rëndësi të veçantë do të marrë bashkëpunimi dhe shkëmbimet ndërkombëtare në fushën e IA-së, ku Kina synon të ndërtojë një sistem global qeverisjeje IA,

duke përballuar sfidat globale në bashkëpunim me vendet e tjera. Këtu shembulli më i freskët është Marrëveshja me Mbretërinë e Bashkuar, e nënshkruar më 25 Janar gjatë vizitës në Pekin të Kryeministrit Starmer; ndër të tjera, Londra do të investojë 15 miliard Dollarë për investime në fushën e shëndetësisë me produktet “Astra Zeneka”. Marrëveshje të ngjashme Kina ka përfunduar edhe me Kanadanë, Finlandën

dhe këtë pritet ta bëjë më vonë me Gjermaninë dhe vende të tjera europiane.

Këtu vlen të theksohet se ndryshe nga Kina, e cila nuk mbajtur qëndrime negative ndaj ujdive perëndimore, SHBA-të kanë bërë paralajmërime dhe kërcënime ndaj Kanadasë dhe Britanisë së Madhe për marrëveshjet e lartpërmendura me Kinën!

Këto qëndrime konstruktive kineze burojnë nga fakti tjetër tejet i rëndësishëm se edhe në politikat shkencore dhe teknologjike, Kina i përmbahet multilaterizmit, të drejtës ndërkombëtare, dialogut institucional dhe respektimit të vendimeve të organizatave ndërkombëtare përkatëse, duke filluar nga OKB-ja dhe filialet e saj përkatëse. Kështu, disa ditë më parë Kina fitoi një proces gjyqësor në Organizatën Botërore të Tregtisë ndaj ish Administratës së Presidentit Biden lidhur me një kredi subvencionuese të saj për shtetasit amerikanë për blerjen e veturave elektrike, si formë e dëmshme e dumpingut social.

Mirëpo prapë, ndryshe nga Kina,



Foto nga VCG

Komisioni European paditi më 3 Shkurt kompaninë e madhe kineze të prodhimit të turbinave të erës, "Goldwind" e cila, sipas BE-së, mund të ketë siguruar subvencione shtetërore. MPJ-ja kineze i përgënjeshtroi akuzat si "akte proteksioniste dhe diskriminuese" për të penguar investimet kineze në Europë. Shqetësimi madhor këtu është se ndërkohë që BE-ja kërkon të nxisë partneritetin ekonomik me Kinën, ajo ngutet duke kaluar në padi gjyqësore, kur të dyja palët i kanë të gjitha mekanizmat e duhura të konsultimeve deri te OBT-ja për t'i sheshuar dhe zgjidhur këto aspekte me mirëkup-

tim dhe jo "majë më majë". Ca më tepër kur dihet, madje edhe vetë kërkerët e OKB-së kanë njohur dhe vlerësuar shprehimisht këto hapa dhe masa kineze në zbatim të Nismës strategjike për Sigurinë Globale të lançuar në Prill 2022 nga Presidenti kinez Xi Jinping; ndër gjashtë komponentët e saj themelore figuron me theks të veçantë siguria dhe pavarësia ekonomike nga vendet e tjera, por ama pa dëmtuar, madje duke e zgjeruar bashkëpunimin me to edhe në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë. Madje, ajo po shoqërohet me vlera të shtuara edhe nga nismat mad-

hore për Zhvillim, Qytetërim dhe Qeverisje Globale.

Së fundi, padyshim që dukuritë, zhvillimet dhe pritshmëritë e mësipërme të Kinës ofrojnë shanse dhe mundësi më të mëdha edhe për bashkëpunimin me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, sidomos të Ballkanit Perëndimor dhe më konkretisht me Shqipërinë. Për fat të mirë, trashëgojmë një traditë shumë të mirë bashkëpunimi dypalësh, ekziston dëshira dhe vullneti i përbashkët politik nga të dyja shtetet dhe qeveritë, kemi forume, nisma, por edhe dinamika pozitive të marrëdhënieve në vitet e fundit.

Këtë e them edhe si ish ekonomist për 15 vite në Ish Ministrinë e Tregtisë së Jashtme në vitet 70 dhe 80, ku pata rastin të shoh dobinë e madhe të ndihmës dhe bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe teknik por edhe dëmet e mëdha që pësoi ekonomia dhe niveli i jetesës së popullit tonë pas prishjes së atyre marrëdhënieve për shkaqe ideologjike të pajustificueshme, sepse rregjimi ynë i atëhershëm si gjithë botës, donte t'i jepte mend edhe Kinës dhe politikës së saj të madhe transformuese.

Ndaj, tani mbetet vetëm që organet dhe institucionet përkatëse, krahas kujdesit dhe vlerësimit të drejte të çdo elementi të çlirohen nga dogmat, paragjykimet dhe tabutë e vjetra por edhe të reja ideologjike. Duke u dhënë përpaësi shanseve, mundësive dhe efekteve të pritshme pozitive të bashkëpunimit me Kinën edhe në drejtim të përpjekjeve për modernizimin e teknologjisë sonë në të gjitha fushat e lartpërmendura, në planin dypalësh, rajonal dhe më gjerë.

**Mirëpo prapë, ndryshe nga Kina, Komisioni European paditi më 3 Shkurt kompaninë e madhe kineze të prodhimit të turbinave të erës, "Goldwind" e cila, sipas BE-së, mund të ketë siguruar subvencione shtetërore. MPJ-ja kineze i përgënjeshtroi akuzat si "akte proteksioniste dhe diskriminuese" për të penguar investimet kineze në Europë.**



Pamje e një linje transmetimi 220 kilovolt që kalon nëpër kullotat dhe shkretëtirat e gjera në qytetin Ordos, Rajoni Autonom i Mongolisë së Brendshme në veri të Kinës, qershor 2025. /Foto nga VCG

# Plani i 15-të Pesëvjeçar ofron një të ardhme të qëndrueshme për bashkëpunimin Kinë-BE




Foto nga VCG

Dr. Jin Ling\*

**B**ota sot ndodhet në një moment kyç. Konferenca e Sigurisë e Mynihut 2026, me temë “Nën shkatërim”, jo vetëm që pasqyron ankthin strategjik të Evropës, por gjithashtu thekson çekuilibrin në rendin dhe rregullat ndërkombëtare. Në vitet e fundit, konfliktet gjeopolitike kanë qenë të vazhdueshme dhe unilateralizmi është përhapur. Në këtë sfond, Plani i 15-të Pesëvjeçar i

Kinës nuk është vetëm një plan zhvillimi i brendshëm që ka të bëjë me 1.4 miliardë njerëz në Kinë, por do të ndikojë thellësisht edhe në zhvillimin e ardhshëm të botës, duke siguruar qëndrueshmëri të fortë dhe një shtysë të brendshme për zhvillimin e marrëdhënieve Kinë-BE. Plani i 15-të Pesëvjeçar propozon zhvillim me cilësi të lartë dhe hapje në nivel të lartë, duke theksuar rritjen e kërkesës së brendshme për të zgjeruar epërsitë e një tregu super të madh. Këto drejtime reformash dhe zhvillimi do të sjellin mundësi

të reja bashkëpunimi për Kinën dhe BE-në, duke krijuar një të ardhme më të qëndrueshme bashkëpunimi.<sup>7</sup>

## I. Plani i 15-të Pesëvjeçar sjell qëndrueshmëri dhe siguri në bashkëpunimin Kinë-BE

Në vitet e fundit, përballë ndryshimeve gjeopolitike, rritjes së antiglobalizimit e proteksionizmit dhe veçanërisht ndryshimit populist të djathtë ekstrem në strategjinë globale të ShBA-së, mjedisi ekonomik global për bashkëpunimin me dobi të ndërsjellë po përballlet me sfida



Foto nga VCG

themelore dhe po riformësohet. Mendësia e “lojës ku fituesi i merr të gjitha” po bëhet gjithnjë e më mbizotëruese dhe ankthi strategjik evropian është intensifikuar gjithashtu në njëfarë mase. Ekonomia evropiane e orientuar drejt eksportit, është shumë e varur nga tregu botëror, dhe është shpërfaqur dobësia e saj përballë konflikteve gjeopolitike e luftës tarifore të ShBA-së, duke penguar ndjeshëm rimëkëmbjen dhe transformimin e saj.

Një mjedis i qëndrueshëm institucional ka qenë gjithmonë një parakusht për bashkëpunimin me dobi të ndërsjellë midis Kinës dhe BE-së, si edhe një garanci kyçe për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm. Në 50 vjetët që nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis Kinës e BE-së, fushat e bashkëpunimit janë zgjeruar vazhdimisht, me tregtinë dhe investimet që po integrohen gjithnjë e më shumë. Tregtia dypalëshe është rritur nga 2.4

miliardë dollarë amerikanë në fillim të marrëdhënieve diplomatike, në rreth 800 miliardë dollarë amerikanë sot, dhe investimet janë shtuar nga pothuajse zero në gati 260 miliardë dollarë amerikanë, duke formuar një marrëdhënie ekonomike simbiotike të fortë. Suksesi i ndërsjellë dhe marrëdhënia simbiotike midis Kinës e BE-së rrjedh jo vetëm nga besimi i Kinës në integrimin evropian, por edhe

nga politika e vendosur e Reformës dhe Hapjes e Kinës, që i solli pritshmëri të qëndrueshme Evropës. Megjithatë, në sfondin e përshkallëzimit të rivalitetit të fuqive të mëdha dhe rritjes së antiglobalizimit, proteksionizmit e nacionalizmit, Evropa po përjeton gjithashtu ankth në lidhje me strategjinë e zhvillimit të Kinës, duke u shqetësuar nëse do të shkojë edhe Kina drejt proteksionizmit dhe se si do ta

**Plani i 15-të Pesëvjeçar përcakton qartë drejtimit strategjike të “zhvillimit me cilësi të lartë” dhe “hapjes në nivel të lartë”, vazhdon parimin e “dhënies së plotë të rolit vendimtar tregut në ndarjen e burimeve” që është karakteristik për ekonominë socialiste të tregut të Kinës, dhe thekson fokusin e ri strategjik të stimulimit dhe rritjes së kërkesës së brendshme. Plani vë në dukje më tej epërsinë e tregut supergjigant të Kinës, duke dërguar një sinjal të vazhdimësisë së politikave, qëndrueshmërisë e hapjes, duke i sjellë qëndrueshmëri dhe hov bashkëpunimit kino-evropian.**

Si një ekonomi e hapur, Evropa është shumë e varur nga tregjet e jashtme, dhe një sistem ekonomik global i qëndrueshëm e i hapur është çelësi për rimëkëmbjen dhe rritjen e saj ekonomike. Në vitin 2025, në sfondin e tronditjeve gjeopolitike dhe luftës tarifore të ShBA-së, rimëkëmbja ekonomike e Evropës ishte e dobët, veçanërisht në Gjermani, një ekonomi kryesore dhe përcaktuese, ku rritja ekonomike vjetore ishte vetëm 0.4%, shumë më poshtë mesatares së BE-së dhe Eurozonës.

”



Një pamje e horizontit të qytetit të Shangait, Kinë, nëntor 2025. / Foto nga VCG

balancojë Kina marrëdhënien midis tregut e qeverisë dhe midis prodhimit e konsumit.

Si ekonomia e dytë më e madhe në botë, partnerja e dytë më e madhe tregtare e BE-së dhe një fuqi ndërkombëtare në rritje, qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e politikave të brendshme e të jashtme të Kinës të demonstruara në Planin e saj të 15-të Pesëvjeçar janë pa dyshim një siguri për Evropën, e cila ka vuajtur nga trazirat globale dhe politikat e çrregullta të administratës së presidentit Trump. Plani i 15-të Pesëvjeçar përcakton qartë drejtimit strategjike të “zhvillimit me cilësi të lartë” dhe “hapjes në nivel të lartë”, vazhdon parimin e “dhënies së plotë të rolit

vendimtar tregut në ndarjen e burimeve” që është karakteristik për ekonominë socialiste të tregut të Kinës, dhe thekson fokusin e ri strategjik të stimulimit dhe rritjes së kërkesës së brendshme. Plani vë në dukje më tej epërsinë e tregut supergjigant të Kinës, duke dërguar një sinjal të vazhdimësisë së politikave, qëndrueshmërisë e hapjes, duke i sjellë qëndrueshmëri dhe hov bashkëpunimit kino-evropian.


## II. Zhvillimi me cilësi të lartë lehtëson përmirësimin dhe transformimin e bashkëpunimit Kinë-BE

Si një plan zhvillimi që lidh të kaluarën dhe të ardhmen në procesin e realizimit në thelb të mod-

ernizimit socialist, Plani i 15-të Pesëvjeçar vazhdon të përqundohet në zhvillimin ekonomik, por i kushton më shumë rëndësi çështjes së zhvillimit me cilësi të lartë dhe reformës e inovacionit si forca lëvizëse themelore. Detyrat kryesore përfshijnë ndërtimin e një sistemi modern industrial dhe përshpejtimin e vetëbesimit teknologjik të nivelit të lartë, duke udhëhequr zhvillimin e forcave të reja prodhuese. Fushat kryesore përfshijnë optimizimin dhe përmirësimin e industrive tradicionale, kultivimin dhe zgjerimin e industrive në zhvillim e të ardhshme, promovimin e zhvillimit me cilësi të lartë dhe efikas të industrisë së shërbimeve, ndërtimin e një sistemi modern të infrastrukturës, promovimin e integritit të thellë të inovacionit teknologjik e industrial dhe përparimin e mëtejshëm të ndërtimit të Kinës Digjitalë dhe Kinës së Gjellbër. Kjo do të thotë që Kina do të evoluojë më tej nga “fabrika e botës” në një “qendër botërore inovacioni” dhe “fushë zbatimi të teknologjisë së gjellbër”. Gjatë vizitës së tij në Kinë, mbreti Felipe VI i Spanjës deklaroi se Perëndimi është i gatshëm të mbajë shkëmbime të ngushta me Kinën, të shfrytëzojë mundësitë e rëndësishme të sjella nga zbatimi i Planit të 15-të Pesëvjeçar nga Kina dhe të forcojë bashkëpunimin në fusha të tilla si tregtia, industria, shkencat e teknologjia dhe energjia e gjellbër. Kancelari gjerman Merz, në një takim me kryeministrin Li Qiang, theksoi se beson që Plani i 15-të Pesëvjeçar i Kinës do t’i sjellë mundësi Gjermanisë e BE-së, dhe u shpreh i gatshëm të eksplorojë potencialin për bashkëpunim në fushat e reja, si



**Si ekonomia e dytë më e madhe në botë, partnerja e dytë më e madhe tregtare e BE-së dhe një fuqi ndërkombëtare në rritje, qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e politikave të brendshme e të jashtme të Kinës të demonstruara në Planin e saj të 15-të Pesëvjeçar janë pa dyshim një siguri për Evropën, e cila ka vuajtur nga trazirat globale dhe politikat e çrregullta të administratës së presidentit Trump. Plani i 15-të Pesëvjeçar përcakton qartë drejtimit strategjike të “zhvillimit me cilësi të lartë” dhe “hapjes në nivel të lartë”, vazhdon parimin e “dhënies së plotë të rolit vendimtar tregut në ndarjen e burimeve” që është karakteristik për ekonominë socialiste të tregut të Kinës, dhe thekson fokusin e ri strategjik të stimulimit dhe rritjes së kërkesës së brendshme. Plani vë në dukje më tej epërsinë e tregut supergjigant të Kinës, duke dërguar një sinjal të vazhdimësisë së politikave, qëndrueshmërisë e hapjes, duke i sjellë qëndrueshmëri dhe hov bashkëpunimit kino-evropian.**




Anijet shkarkojnë mallra në Portin e Ri Shidao në Rongcheng, Provinca Shandong e Kinës Lindore, nëntor 2025. /Foto nga VCG

shkenca dhe teknologjia. Zhvillimi me cilësi të lartë i Kinës ofron një shtysë të re për bashkëpunimin Kinë-BE. Me inovacionin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të Kinës në fushat e gjelbra dhe digjitale, bashkëpunimi ekonomik e tregtar kino-evropian po ngrihet vazhdimisht në cilësi, po përmirësohet dhe po transformohet. Në vitin 2025, bashkëpunimi ekonomik e tregtar kino-evropian ka demonstruar rritjen e qëndrueshme

të industrive tradicionale dhe përmirësimin e industrive në zhvillim. Tregtia në “tre fushat e reja”, si produktet e gjelbra dhe automjetet me energji të re, po rritet me shpejtësi, dhe përqindja e produkteve me vlerë të shtuar të lartë e teknologji të lartë në tregti vazhdon të ngrihet. Për sa u përket investimeve, kompanitë gjermane po investojnë gjithnjë e më shumë në projekte të mëdha kërkimi e zhvillimi në Kinë, duke synuar të forcojnë praninë

e tyre afatgjatë në tregun kinez. Investimet e kompanive kineze në Evropë, si BYD dhe CATL, përfaqësohen gjithashtu nga industri të gjelbra, duke treguar se bashkëpunimi ekonomik e tregtar kino-evropian po përjeton përmirësim e transformim. Inovacioni i gjelbër dhe digjital i përmendur në Planin e 15-të Pesëvjeçar të Kinës do të ofrojë më tej një shtysë të re për përmirësimin dhe transformimin e bashkëpunimit kino-evropian. Në



fushën e automjeteve me energji të re, epërsitë e Kinës sa u përket baterive, motorëve dhe zinxhirëve inteligjentë të furnizimit mund të kombinohen thellësisht me ekspertizën e Evropës në projektimin e automjeteve, markat e nivelit të lartë dhe kërkimin e zhvillimit të përparuar, siç janë bateritë në gjendje të ngurtë dhe qelizat e karburantit me hidrogjen, për të përcaktuar së bashku standardet e ardhshme të lëvizshmërisë. Në ekonominë qarkulluese, teknologjitë e përparuara të Evropës në trajtimin

e mbeturinave dhe riciklimin e materialeve mund ta ndihmojnë Kinën të ndërtojë një sistem “qytetesh pa mbeturina”. Thellimi i ekonomisë digjitale të Kinës gjatë periudhës së Planit të 15-të Pesëvjeçar mund të fuqizojë transformimin digjital të Evropës.

### **III. Rritja e kërkesës së brendshme dhe hapja në nivel të lartë: Zgjerimi i mundësive për bashkëpunimin Kinë-BE**

Si një ekonomi e hapur, Evropa është shumë e varur nga tregjet

e jashtme, dhe një sistem ekonomik global i qëndrueshëm e i hapur është çelësi për rimëkëmbjen dhe rritjen e saj ekonomike. Në vitin 2025, në sfondin e tronditjeve gjeopolitike dhe luftës tarifore të ShBA-së, rimëkëmbja ekonomike e Evropës ishte e dobët, veçanërisht në Gjermani, një ekonomi kryesore dhe përcaktuese, ku rritja ekonomike vjetore ishte vetëm 0.4%, shumë më poshtë mesatares së BE-së dhe Eurozonës. Në këtë sfond, objektivat e zhvillimit të Planit të 15-të Pesëvjeçar të Kinës për rritjen e kërkesës së brendshme dhe strategjia e saj për zgjerimin e hapjes në marrëdhëniet ekonomike të jashtme pa dyshim do të sjellin mundësi të reja për rritjen ekonomike evropiane dhe bashkëpunimin Kinë-BE.

Objektivat e zhvillimit të Planit të 15-të Pesëvjeçar për rritjen e kërkesës së brendshme do të shfrytëzojnë më tej potencialin e tregut të popullsisë masive prej 1.4 miliardë banorësh të Kinës, duke u përkthyer drejtpërdrejt në kërkesë për mallra dhe shërbime të importuara me cilësi të lartë. BE-ja është burimi më i madh i importeve të mallrave të konsumit në Kinë. Zgjerimi i vazhdueshëm i kërkesës së brendshme nga Kina do të thotë që produktet evropiane, si automjetet, makineritë, mallrat luksoze dhe ushqimet, do të kenë një hapësirë më të gjerë tregu. Rritja e kërkesës së brendshme kineze do t’u ofrojë gjithashtu kompanive evropiane që operojnë në Kinë, pritshmëri të qëndrueshme të tregut, duke forcuar besimin e tyre të struktura industriale të Kinës. Ndërkohë, përmirësimi i kërkesës së brendshme në Kinë po nxit

kërkesën për prodhim të nivelit të lartë, teknologji të gjelbra dhe shërbime digjitale, duke forcuar më tej plotësueshmërinë industriale midis Kinës e Evropës në fusha të tilla si pajisjet e nivelit të lartë, energjia e pastër dhe inteligjenca artificiale, e duke promovuar bashkërendimin dhe integrimin e investimeve midis ndërmarrjeve kineze e evropiane.

Përballë ringjalljes së nacionalizmit, proteksionizmit në rritje dhe një momenti kritik të ristrukturimit në sistemin global të tregtisë së lirë, strategjia e përcaktuar qartë e Planit të 15-të Pesëvjeçar për bashkëpunim të hapur dhe përfitim të ndërsjellë, duke zgjeruar në mënyrë aktive hapjen e pavarur, duke promovuar zhvillimin inovativ të tregtisë, duke zgjeruar hapësirën e investimeve dypalëshe dhe ndërtimin e përbashkët me cilësi të lartë të “Një brez, një rrugë”, thekson gatishmërinë e sinqertë të Kinës për të ndarë mundësitë e zhvillimit me të gjitha palët. Ndër këto masa, zgjerimi i hyrjes në treg dhe fushat e hapjes me fokus në sektorin e shërbimeve, zgjerimi i zonave dhe rajoneve të hapjes së njëanshme, promovimi i zhvillimit të balancuar të importit dhe eksportit, zvogëlimi i listës negative për hyrjen e investimeve të huaja, promovimi i riinvestimit të kapitalit të huaj në Kinë, përmirësimi i sistemit të garancisë së shërbimeve për investimet e huaja, zbatimi i plotë i trajtimit kombëtar, promovimi i qarkullimit efikas, të përshtatshëm e të sigurt ndërkufitar të të dhënave, si edhe krijimi i një mjedisi institucional transparent, të qëndrueshëm e të parashikueshëm, të gjitha këto nënkuptojnë një ndryshim

”  
Kina dhe BE-ja kanë dallime në histori, sisteme dhe kulturë, 50 vjetët e bashkëpunimit midis dy palëve kanë provuar vazhdimisht se ato mund të kërkojnë terren të përbashkët duke lënë mënjanë dallimet, duke krijuar një partneritet strategjik të qëndrueshëm të bazuar në respektin e ndërsjellë, barazinë dhe përfitimin e përbashkët. Pa përmendur pastaj faktin që, në sfondin kur rendi dhe rregullat ndërkombëtare përballeshin sot me kërcënimin e shkatërrimit, Kina dhe BE-ja kanë një përgjegjësi dhe interes të përbashkët për të parandaluar që bota të kthehet në “ligjin e xhunglës”.

në hapjen e Kinës nga vendosja e fokusit në të kaluarën në qarkullimin e mallrave dhe faktorëve të prodhimit, në një qasje më të institucionalizuar bazuar në rregulla, menaxhim dhe standarde. Kjo do të krijojë një mjedis institucional më të përshtatshëm për tregtinë e investimet globale dhe do të sjellë mundësi të jashtëzakonshme zhvillimi e bashkëpunimi për vendet e mbarë botës, përfshirë ato evropiane. Në veçanti, zgjerimi i hyrjes në treg dhe hapja sektoriale, me fokus në sektorin e shërbimeve, do të ofrojë më shumë mundësi për eksportuesit evropianë të shërbimeve. Sigurisht, qëndrueshmëria dhe mundësitë e sjella nga Plani i 15-të Pesëvjeçar për bashkëpunimin Kinë-BE, duke e transformuar potencialin e bashkëpunimit në realitet, kërkojnë që të dyja palët të forcojnë besimin e ndërsjellë strategjik në

sfondin e ndryshimeve gjeopolitike, të kenë mirëkuptim të ndërsjellë dhe veçanërisht të kapërcejnë konfliktet gjeopolitike e pengesat ideologjike.

Duke u pozicionuar si partnere, ato duhet të arrijnë një bashkëpunim me përfitime të ndërsjella nëpërmjet bashkëpunimit pragmatik, duke u sjellë dobi të dyja palëve dhe botës. Përballë marrëdhënies së përçarë midis Evropës dhe SHBA-së, zhvendosja e fundit “drejt lindjes” e udhëheqësve evropianë që vizitojnë Kinën, nuk duhet të jetë një masë e përkohshme, por një zgjedhje strategjike e bërë nga një perspektivë strategjike dhe nga një pikëpamje më e gjerë historike, duke u bazuar në interesat e përbashkëta të Kinës, BE-së dhe botës. Në fund të fundit, megjithëse Kina dhe BE-ja kanë dallime në histori, sisteme dhe kulturë, 50 vjetët e bashkëpunimit midis dy palëve kanë provuar vazhdimisht se ato mund të kërkojnë terren të përbashkët duke lënë mënjanë dallimet, duke krijuar një partneritet strategjik të qëndrueshëm të bazuar në respektin e ndërsjellë, barazinë dhe përfitimin e përbashkët. Pa përmendur pastaj faktin që, në sfondin kur rendi dhe rregullat ndërkombëtare përballeshin sot me kërcënimin e shkatërrimit, Kina dhe BE-ja kanë një përgjegjësi dhe interes të përbashkët për të parandaluar që bota të kthehet në “ligjin e xhunglës”.

*\*Zëvendës drejtoresh e Institutit të Studimeve Evropiane dhe drejtoresh e Institutit të Qeverisjes Globale dhe Organizatave Ndërkombëtare pranë Akademisë Kineze të Studimeve Ndërkombëtare*

# Plani i 15-të pesëvjeçar i Kinës dhe strategjia e hapjes ndaj botës së jashtme



Ekspozita e shtatë Ndërkombëtare e Importit të Kinës ka filluar në Shanghai të Kinës Lindore, nëntor 2024. / Foto nga CFP

Redion Luli\*

Planet pesëvjeçare për zhvillimin socio-ekonomik kanë mbetur një mjet kyç i menaxhimit strategjik në Republikën Popullore të Kinës për dekada të tëra. Ato shërbejnë jo vetëm si mjete të planifikimit ekonomik, por gjithashtu pasqyrojnë ndryshime të thella në mendimin politik, ideologjinë e zhvillimit dhe orientimin e politikës së jashtme të vendit. Hartimi i Planit të 15-të Pesëvjeçar të Kinës, që mbulon periudhën 2026–2030, po zhvillohet në sfondin e transformimit ekonomik global, intensifikimit të konkurrencës gjeopolitike dhe krizës së modelit të mëparshëm të globalizimit. Në këtë kontekst, rëndësi merr çështja e hapjes së mëtejshme të

Kinës ndaj botës së jashtme dhe ripërcaktimi i vetë konceptit të “hapjes”.

Që nga fillimi i politikave të reformave dhe hapjes në fund të viteve 1970, Kina ka evoluar nga një ekonomi e planifikuar e izoluar në një nga fuqitë kryesore tregtare dhe investuese në botë. Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), investimet e huaja në shkallë të gjerë dhe integrimi në zinxhirët globalë të tregtisë janë bërë faktorë kyç në rritjen e saj të shpejtë ekonomike. Megjithatë, sukseset e modelit të mëparshëm u shoqëruan me pika të dobëta: varësia nga tregjet e huaja, kufizimet teknologjike dhe zhvillimi jo homogjen. Kjo është arsyeja pse, në vitet e fundit, udhëheqësit kinezë kanë folur gjithnjë e më shumë jo thjesht për “hapjen ndaj botës së jashtme”, por edhe për cilësinë dhe fokusin e saj strategjik.



Porti Yangshan i Shangait në Shangai të Kinës Lindore, korrik 2024. / Foto nga CFP

Plani i 15-të Pesëvjeçar vijon logjikisht linjën e vendosur në ciklin e mëparshëm, veçanërisht konceptin e “qarkullimit të dyfishtë”. Kjo strategji i jep përparësi tregut të brendshëm dhe kërkesës së brendshme, duke ruajtur njëkohësisht pjesëmarrjen aktive në ekonominë ndërkombëtare. Ndryshe nga interpretimet e përhapura, kjo nuk do të thotë mbyllje e Kinës ose kthim drejt autarkisë. Përkundrazi, modeli kinez parashikon një kombinim më të balancuar të qëndrueshmërisë së brendshme

dhe hapjes së jashtme, ku kjo e fundit transformohet në një mjet për rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare dhe jo në një burim varësie strategjike. Hapja e Kinës ndaj botës së jashtme sipas Planit të 15-të Pesëvjeçar po bëhet gjithnjë e më selektive dhe e institucionalizuar. Kina vazhdon të zgjerojë aksesin në treg për kompanitë e huaja, veçanërisht në sektorë të tillë si financat, logjistika, shërbimet e teknologjisë së lartë, energjia e gjelbër dhe ekonomia digjitale. Reduktimi i “listave të zeza” për investimet e huaja shoqërohet me mbrojtje të forcuar ligjore për bizneset, mekanizma të përmirësuar të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe mbrojtje të shtuar të pronësisë intelektuale. Këto masa synojnë krijimin e një mjedisi biznesi të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm, të aftë për të tërhequr kapital afatgjatë dhe jo spekulativ.

Zonat e tregtisë së lirë dhe territoret ekonomike speciale të gjeneratës së re po bëhen një element i rëndësishëm i kësaj hapeje të re. Ato shërbejnë si platforma eksperimentale për testimin e formave inovative të rregullimit të tregtisë, transaksioneve financiare dhe kalimit të të dhënave ndërkufitare. Porti i Tregtisë së Lirë i Hainanit zë një vend të veçantë, duke u pozicionuar si një model për liberalizimin e thellë dhe integrimin e Kinës në ekonominë globale. Përmes mekanizmave të tillë, Pekini kërkon të zbatojë gradualisht, por në mënyrë të kontrolluar, reforma institucionale në

**Zonat e tregtisë së lirë dhe territoret ekonomike speciale të gjeneratës së re po bëhen një element i rëndësishëm i kësaj hapeje të re. Ato shërbejnë si platforma eksperimentale për testimin e formave inovative të rregullimit të tregtisë, transaksioneve financiare dhe kalimit të të dhënave ndërkufitare. Porti i Tregtisë së Lirë i Hainanit zë një vend të veçantë, duke u pozicionuar si një model për liberalizimin e thellë dhe integrimin e Kinës në ekonominë globale. Përmes mekanizmave të tillë, Pekini kërkon të zbatojë gradualisht, por në mënyrë të kontrolluar, reforma institucionale në nivel kombëtar.**



Turistë të huaj duke bërë selfie në Muzeun e Pallatit Kombëtar, Pekin, kryeqyteti i Kinës, shtator 2025. / Foto nga CFP

nivel kombëtar.

Digjitalizimi po bëhet një tjetër dimension kyç i hapjes ndaj botës së jashtme. Mes rritjes së shpejtë të tregtisë elektronike, platformave digjitale dhe shërbimeve online ndërkuftare, Kina po zhvillon në mënyrë aktive kuadrin e saj rregullator dhe teknologjik për tregtinë digjitale. Në të njëjtën kohë, vendi po përpiqet të marrë pjesë në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë, duke ofruar një vizion alternativ për rregullimin e të

dhënave, sigurinë kibernetike dhe sovranitetin digjital. Plani i 15-të Pesëvjeçar e sheh hapjen digjitale si një faktor në rritjen e efektivitetit të marrëdhënieve ekonomike të jashtme dhe zgjerimin e pranisë së kompanive kineze në tregjet globale.

Iniciativa “Një Brez, një Rrugë” mbetet një fokus kyç i strategjisë së hapjes. Megjithatë, përmbajtja e saj po evoluon ndjeshëm. Ndërsa në fazat e hershme theksi ishte në projektet e infrastrukturës në shkallë të gjerë dhe eksportet e kapitalit, në ciklin e ri pesëvjeçar përparësia po zhvendoset drejt qëndrueshmërisë, mirëqenies mjedisore dhe ndikimit ekonomik lokal. Investimet kineze po kanalizohen gjithnjë e më shumë në zhvillimin e bashkëpunimit industrial, qendrave logjistike, infrastrukturës digjitale dhe teknologjive të gjelbra në vendet partnere. Kështu, iniciativa po integrohet gjithnjë e më shumë në konceptin e përgjithshëm të “hapjes ndaj botës së jashtme me cilësi të lartë”.

Dimensioni teknologjik i Planit të 15-të Pesëvjeçar demonstroi një kombinim kompleks të bashkëpunimit dhe vetëmjaftueshmërisë. Nga njëra anë, Kina mbetet e hapur ndaj shkëmbimit shkencor ndërkombëtar, kërkimit të përbashkët shkencor dhe lëvizshmërisë akademike. Nga ana tjetër, kufizimet e jashtme gjithnjë e më shumë rriten dhe presioni i sanksioneve po e shtyn Pekinin

**Iniciativa “Një Brez, një Rrugë” mbetet një fokus kyç i strategjisë së hapjes. Megjithatë, përmbajtja e saj po evoluon ndjeshëm. Ndërsa në fazat e hershme theksi ishte në projektet e infrastrukturës në shkallë të gjerë dhe eksportet e kapitalit, në ciklin e ri pesëvjeçar përparësia po zhvendoset drejt qëndrueshmërisë, mirëqenies mjedisore dhe ndikimit ekonomik lokal. Investimet kineze po kanalizohen gjithnjë e më shumë në zhvillimin e bashkëpunimit industrial, qendrave logjistike, infrastrukturës digjitale dhe teknologjive të gjelbra në vendet partnere.**



Anije mallrash në Portin Qingdao, Qyteti Qingdao, Provinca Shandong e Kinës Lindore, Mars, 2025. / Foto nga VCG

të përshpejtojë zhvillimin e teknologjive të veta kritike. Gjysmëpërçuesit, inteligjenca artificiale, informatika kuantike dhe bioteknologjia shihen si themelet e sovranitetit afatgjatë. Hapja në këtë fushë po bëhet selektive dhe e kalibruar strategjikisht, e fokusuar në përfitimin e ndërsjellë dhe reduktimin e pikave të dobëta.

Axhenda mjedisore i shton një dimension shtesë politikës së hapjes së Kinës. Kina deklaron gatishmërinë e saj për të luajtur një rol aktiv në luftën globale kundër ndryshimeve klimatike

duke promovuar investimet e gjelbra, financat e qëndrueshme dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në tranzicionin energjetik. Sipas Planit të 15-të Pesëvjeçar, standardet mjedisore shihen gjithnjë e më shumë jo si një kufizim, por si një faktor avantazhi konkurrues dhe një formë e re e ndërveprimit ekonomik të jashtëm, veçanërisht me vendet e Jugut Global.

Konteksti gjeopolitik në të cilin po formulohet Plani i ri Pesëvjeçar nuk mund të injorohet. Rivaliteti strategjik në rritje, fragmentimi i ekonomisë globale dhe dobësimi i institucioneve shumëpalëshe po e detyrojnë Kinën të kërkojë formate alternative për bashkëpunim. Marrëveshjet rajonale si Partneriteti Ekonomik Gjithëpërfshirës Rajonal, forcimi i lidhjeve me ekonomitë në zhvillim dhe mbështetja për multilateralizmin po bëhen elementë të rëndësishëm të politikës së saj të jashtme. Hapja e Kinës ndaj botës së jashtme po pozicionohet gjithnjë e më shumë si një alternativë ndaj proteksionizmit të njëanshëm dhe tregtisë së politizuar.

Për sa i përket marrëdhënieve Kinë-BE, Ministri



Klientët zgjedhin mallra në një dyqan pa taksa doganore në Haikou, Provinca Hainan. / Foto nga VCG



Foto nga VCG

i jashtëm kinez Wang Yi deklaroi së fundmi në Konferencën e Sigurisë në Mynih se “Kina e konsideron BE-në një pol të rëndësishëm në një botë shumëpolare dhe të dyja palët janë partnerë, jo rivalë”. Wang Yi vuri në dukje se ky vit shënon 50-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Kinës dhe BE-së. Ai deklaroi më tej se Kina është e gatshme të punojë me vendet anëtare të BE-së, për të thelluar komunikimin strategjik dhe bashkëpunimin reciprokisht të dobishëm, si dhe për ta udhëhequr botën drejt një të ardhmeje të ndritur paqeje, sigurie, prosperiteti dhe zhvillimi.

Ndërsa referuar marrëdhënieve të Shqipërisë me Kinën, duhet theksuar se aktualisht ekziston një klimë shumë e mirë bashkëpunimi dypalësh, me një nivel të kënaqshëm të dialogut politik dhe të shkëmbimit të vizitave në nivele të lartë. Vizitat e niveleve të larta mes Kinës dhe Shqipërisë janë shoqëruar edhe me aktivitete të rëndësishme ekonomike e kulturore, si forume ekonomike, ekspozita etj. Niveli aktual i marrëdhënieve ka krijuar të gjitha premiset për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve reciproke në të gjitha fushat. Të dy vëndet synojnë në vijim forcimin e dialogut ndërshtetëror në të gjitha nivelet: në atë qeveritar, parlamentar, partiak, jo-qeveritar, akademik, kulturor, si dhe në të gjitha fushat me interes reciprok. Ndërmjet të dy

vendeve janë lidhur mbi 50 marrëveshje ekonomike. Aktualisht, Kina është partneri i tretë tregtar i Shqipërisë, me 8% të totalit të vëllimit tregtar, ndërsa eksportet shqiptare drejt Kinës vazhdojnë të rriten ndjeshëm. Kjo tendencë do të ruhet edhe në 2026.

Në një kontekst global, Plani i 15-të Pesëvjeçar i Kinës shtrihet përtej “kufijve” të përcaktuar në një dokument të brendshëm të qeverisë kineze. Zbatimi i tij ndikon në strukturën e tregtisë globale, dinamikën e investimeve, zhvillimin teknologjik dhe formimin e normave të reja të ndërveprimit ekonomik. Për shumë vende dhe rajone, politika e hapjes e Kinës po bëhet një faktor që përcakton strategjitë e tyre të zhvillimit dhe prioritetet e ekonomisë së jashtme.

Në fund të fundit, Plani i 15-të Pesëvjeçar pasqyron pjekurinë e modelit kinez të zhvillimit dhe përshtatjen e tij me realitetet e shekullit të 21-të. Hapja ndaj botës së jashtme mbetet një parim themelor, por është i mbushur me përmbajtje të re bazuar në autonominë strategjike, fleksibilitetin institucional dhe një vizion afatgjatë. Kina ofron një model hapjeje në të cilin integrimi global nuk bie ndesh me sovranitetin kombëtar, por shërben si një mjet për zhvillim të qëndrueshëm në një rend global në ndryshim.

*\*Ekspert i së Drejtës Ndërkombëtare*

# Nga Toka te Teknologjia: TRANSFORMIMI RURAL NË KINËN MODERNE



Një pamje e qytetit Yanqiao në Wuhu, provinca Anhui e Kinës Lindore, 20 tetor 2024. / Foto nga CFP

## Etleva Xhajanka

Zhvillimi rural në Kinë, i nxitur nga Plani i 15-të Pesëvjeçar, paraqet një model unik të zhvillimit të qëndrueshëm, ku transformimi ekonomik bashkëjeton me ruajtjen e ekosistemeve dhe kulturës lokale. Përmes investimeve të strukturuar në infrastrukturë, teknologji bujqësore, energji të rinovueshme dhe menaxhim të burimeve natyrore, Kina po ndërton fsha-

tra të integruar, që kombinojnë produktivitetin ekonomik me mirëqenien sociale. Ky model nuk fokusohet thjesht tek rritja e prodhimit, por edhe tek përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve ruralë, përmes qasjeve inovative në arsim, shëndetësi, transport dhe mbrojtjen e mjedisit. Për më tepër, strategjia e zhvillimit rural të Kinës, promovon një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisë, komuniteteve dhe sektorit privat, duke krijuar një ekosistem të qëndrueshëm zhvillimi, i cili

mund të shërbejë si shembull për vende të tjera në transformimin e zonave rurale në motorë të rritjes ekonomike dhe social-ekologjike.

### Ndërtimi rural në Kinë: Arkitektura e heshtur e modernizimit kombëtar

Në hartën e madhe të modernizimit kinez, fshati nuk është më periferia e harruar e zhvillimit, por një hapësirë strategjike ku projektohet e ardhmja. Ndërtimi rural në Kinë, i lexuar përtej shifrave dhe programeve



Një robot inteligjent mbledhës i zhvilluar nga Akademia e Shkencave Bujqësore Zhejiang debuton në Ekspozitën Bujqësore Zhejiang 2024, nëntor 2024. / Foto nga CFP

teknike, shfaqet sot si një proces i thellë transformimi shoqëror, ekonomik dhe territorial – një arkitekturë e heshtur që mban peshën e stabilitetit kombëtar dhe ambicieve globale të vendit. Në qendër të këtij transformimi qëndron një ide themelore: modernizimi ki-

nez nuk mund të jetë i plotë pa modernizimin rural. Fshati nuk shihet më vetëm si burim ushqimi apo rezervuar force pune, por si një hapësirë jetese, prodhimi, kulture dhe inovacioni, e integruar në mënyrë organike me qytetin dhe ekonominë kombëtare.

### Ruraliteti si çështje gjeoekonomike

Rilindja rurale në Kinë nuk është thjesht një projekt social; ajo është një strategji gjeoekonomike. Në një vend me popullsi të madhe, me presion të vazhdueshëm mbi burimet dhe me ambicie për siguri ushqimore, fshati përbën një nyje kritike të sovranitetit ekonomik.

Politikat për forcimin e kapaciteteve prodhuese bujqësore, mbrojtjen e tokës dhe zhvillimin e zinxhirëve të vlerës në bujqësi janë pjesë e një arkitekture më të gjerë sigurie kombëtare. Ruajtja e “vijës së kuqe” të tokës bujqësore dhe investimi në tokë të standardeve të larta nuk janë thjesht masa teknike, por garanci për stabilitet afatgjatë në një botë gjithnjë e më të frag-



**Politikat për forcimin e kapaciteteve prodhuese bujqësore, mbrojtjen e tokës dhe zhvillimin e zinxhirëve të vlerës në bujqësi janë pjesë e një arkitekture më të gjerë sigurie kombëtare. Ruajtja e “vijës së kuqe” të tokës bujqësore dhe investimi në tokë të standardeve të larta nuk janë thjesht masa teknike, por garanci për stabilitet afatgjatë në një botë gjithnjë e më të fragmentuar dhe të pasigurt.**



Një robot inteligjent mbledhës i zhvilluar nga Akademia e Shkencave Bujqësore Zhejiang debuton në Ekspozitën Bujqësore Zhejiang 2024, nëntor 2024. / Foto nga CFP

mentuar dhe të pasigurt. Kina e sheh bujqësinë jo si një sektor të prapambetur, por si një shtyllë moderne të ekonomisë kombëtare, të teknologjizuar, të gjelbër dhe të orientuar drejt cilësisë dhe markës. Në këtë kuptim, fshati bëhet laborator i një modeli të ri zhvillimi, ku prodhimi dhe ekologjia nuk janë kundërshtare, por aleate.

### **Nga prodhimi tradicional te bujqësia inteligjente**

Një nga shtyllat kryesore të ndërtimit rural është transformimi teknologjik i bujqësisë. Investimet në farëra të avancuara, makineri bujqësore inteligjente dhe pajisje të përshtatura për terrene të vështira shënojnë kalimin nga bujqësia

intensive në krah pune drejt bujqësisë së bazuar në dije dhe inovacion.

Ky tranzicion ka një domethënie të thellë gjeoekonomike: ai rrit produktivitetin pa rritur presionin mbi tokën, ul varësinë nga importet ushqimore dhe krijon një sistem prodhimi më rezistent ndaj krizave klimatike dhe tregtare.

Paralelisht, zhvillimi i një sistemi ushqimor të larmishëm – që përfshin bujqësinë, blegtorinë, peshkimin dhe ekonominë pyjore – synon të ndërtojë elasticitet strukturor. Fshati kinez, në këtë vizion, nuk është monokulturë, por mozaik funksionesh ekonomike që e bëjnë atë më të qëndrueshëm dhe më konkurrues.

“

**Një nga shtyllat kryesore të ndërtimit rural është transformimi teknologjik i bujqësisë. Investimet në farëra të avancuara, makineri bujqësore inteligjente dhe pajisje të përshtatura për terrene të vështira shënojnë kalimin nga bujqësia intensive në krah pune drejt bujqësisë së bazuar në dije dhe inovacion.**



Një robot inteligjent mbledhës i zhvilluar nga Akademia e Shkencave Bujqësore Zhejiang debuton në Ekspozitën Bujqësore Zhejiang 2024, nëntor 2024. / Foto nga CFP

### Fshati si hapësirë jetese moderne

Ndërtimi rural nuk kufizohet te prodhimi. Një nga dimensionet më domethënëse të këtij procesi është përmirësimi i kushteve të jetesës. Infrastrukturë moderne, shërbime publike më të aksesueshme, mjedisi i pastër dhe planifikim territorial i integruar janë elementë kyç për ta bërë fshatin një vend ku njerëzit jo vetëm punojnë, por edhe zgjedhin të jetojnë.

Përvoja e programeve pilot, si modeli i Zhejiang-ut, tregon se rilindja rurale kërkon qasje të diferencuar, të përshtatur me karakteristikat lokale. Nuk ka një model unik për të gjitha zonat rurale të Kinës; ka strategji fleksibël, të ndërtuara mbi identitetin, burimet dhe potencialin e secilit territor.

Në këtë kuadër, ndërtimi i “fshatit të bukur” nuk është një slogan estetik, por një projekt i plotë socio-ekonomik, ku

mjedisi, kultura dhe ekonomia ndërthuren për të krijuar hapësira jetese dinjitoze dhe funksionale.

### Integrimi urban-rural: fundi i një ndarjeje historike

Një nga ambicet më të mëdha të politikave kineze është kapërcimi i ndarjes tradicionale midis qytetit dhe fshatit. Integrimi urban-rural shfaqet si një proces dy-drejtimesh: qyteti sjell kapital, teknologji dhe shërbime në fshat, ndërsa fshati ofron burime, hapësirë dhe stabilitet social.

Ky integrim përforcohet nga reformat në menaxhimin e tokës, nga qarkullimi më fleksibël i faktorëve të prodhimit dhe nga politikat që inkurajojnë njerëzit të jetojnë, punojnë dhe investojnë në zonat rurale. Fshati nuk është më stacion tranziti drejt qytetit, por desti-

**Një nga ambicet më të mëdha të politikave kineze është kapërcimi i ndarjes tradicionale midis qytetit dhe fshatit. Integrimi urban-rural shfaqet si një proces dy-drejtimesh: qyteti sjell kapital, teknologji dhe shërbime në fshat, ndërsa fshati ofron burime, hapësirë dhe stabilitet social.**

Duke investuar në fshat, Kina po investon në stabilitetin e saj të brendshëm dhe në peshën e saj gjeoekonomike globale. Në një botë të përballur me pasiguri ushqimore, kriza klimatike dhe polarizim social, modeli kinez i ndërtimit rural ofron një qasje alternative: zhvillim i balancuar, i planifikuar dhe i orientuar drejt së ardhmes. Në këtë kuptim, në filozofinë e qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për zhvillimin rural, fshati nuk është thjesht rrënja e së kaluarës, por themeli mbi të cilin ngrihet modernizimi i së nesërmes.

”



Një fermer përdor një dron për pllenim në Zhangjiakou, provincën Hebei të Kinës Veriore, gusht, 2024. / Foto nga VCG



Një banor vendas mbledh nektarina në qytetin Longchang, Weining Yi, Qarku Autonom Hui dhe Miao, Provinca Guizhou e Kinës Jugperëndimore, në qershor 2025. / Foto nga VCG

nacion zhvillimi. Në këtë kontekst, urbanizimi nuk shihet si zhvendosje masive, por si proces i njerëz-cen-truar, që ruan lidhjet sociale dhe kulturore, ndërsa garanton akses të barabartë në shërbime publike.

### **Ekonomia rurale dhe zinxhirët e vlerës**

Rilindja rurale në Kinë synon të krijojë ekonomi lokale dinamike, të bazuara në avantazhet krahasuese të çdo zone. Zhvillimi i industrive karakteristike rurale, përpunimi agro-industrial dhe integrimi i sektorëve primar, sekondar dhe terciar krijojnë zinxhirë vlere që mbajnë më shumë të ardhura brenda komuniteteve rurale. Ky model ul varësinë nga tra-

nsfertat fiskale dhe forcon vetë-qëndrueshmërinë ekonomike të fshatit. Në të njëjtën kohë, ai e lidh zhvillimin rural

me tregjet kombëtare dhe ndër-kombëtare, duke e bërë fshatin pjesë aktive të ekonomisë globale.



*Rilindja rurale në Kinë synon të krijojë ekonomi lokale dinamike, të bazuara në avantazhet krahasuese të çdo zone. Zhvillimi i industrive karakteristike rurale, përpunimi agro-industrial dhe integrimi i sektorëve primar, sekondar dhe terciar krijojnë zinxhirë vlere që mbajnë më shumë të ardhura brenda komuniteteve rurale.*



### **Lufta kundër varfërisë si proces i vazhdueshëm**

Edhe pse Kina ka arritur rezultate historike në uljen e varfërisë, ndërtimi rural e sheh këtë arritje jo si fund, por si fillim të një faze të re. Parandalimi i rikthimit në varfëri dhe mbështetja e zonave ende të brishta janë pjesë e një mekanizmi afatgjatë sigurie sociale.

Kjo qasje reflekton një filozofi zhvillimi që kombinon rritjen ekonomike me drejtësinë sociale. Fshati, në këtë vizion, nuk lihet pas nga modernizimi, por mbrohet dhe fuqizohet për të qenë pjesë e tij.



Një banore vendas paketon nektarina në qytetin Longchang, Weining Yi, Qarkun Autonom Hui dhe Miao, Provinca Guizhou e Kinës Jugperëndimore, më 6 qershor 2025. / Foto nga VCG

### **Ndërtimi rural si projekt civilizues**

Në thelb, ndërtimi rural në Kinë është më shumë se një program zhvillimi: është një projekt civilizues. Ai synon të krijojë një shoqëri ku zhvillimi ekonomik, harmonisë sociale dhe mbrojtja e mjedisit ecin së bashku.

Duke investuar në fshat, Kina po investon në stabilitetin e saj të brendshëm dhe në peshën e saj gjeoekonomike globale. Në një botë të përballur me pasiguri ushqimore, kriza klimatike dhe polarizim social, modeli kinez i ndërtimit rural ofron një qasje alternative: zhvillim i balancuar, i planifikuar dhe i orientuar drejt së ardhmes.

Në këtë kuptim, në filozofinë e qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për zhvillimin rural, fshati nuk është thjesht rrënja e së kaluarës, por themeli mbi të cilin ngrihet modernizimi i së nesërmes.

**Nga Fshati Global te Partneriteti Strategjik: Boshti Kinë–Europë–Shqipëri në Zhvillimin Rural**  
Përtej dimensionit të brend-

shëm, transformimi rural në Republika Popullore e Kinës krijon hapësira reflektimi dhe bashkëpunimi edhe në nivel ndërkombëtar, duke shndërruar fshatin në një platformë strategjike bashkëpunimi, Kinë–Europë–Shqipëri në Zhvillimin Rural, ku fshati shfaqet si urë lidhëse për praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në një kontekst global të shënuar nga tranzicioni energjetik, pasiguritë ushqimore dhe rikonfigurimi i zinxhirëve të furnizimit, përvoja kineze e zhvillimit rural paraqet hapësira konkrete reflektimi edhe për Europën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Ideja e për-bashkët është që përvoja kineze mund të ofrojë modele të adaptueshme për Europën dhe Shqipërinë.

Për Bashkimin Europian, i cili po përballlet me sfida të plakjes së popullsisë rurale, fragmentimit të tokës dhe tranzicionit të gjelbër, modeli kinez i integritit të teknologjisë, planifikimit territorial dhe zhvillimit të zinxhirëve të vlerës ofron një rast studimi

mbi mënyrën sesi modernizimi bujqësor mund të kombinohet me stabilitet social dhe siguri ushqimore.

Për Shqipërinë, si vend me strukturë territoriale dhe demografike ku zonat rurale zënë një peshë të rëndësishme, bashkëpunimi me Kinën mund të eksplorohet në disa drejtime strategjike: transferim teknologjie në bujqësi inteligjente; investime në përpunimin agro-industrial; energji të rinovueshme në zona rurale dhe shkëmbim eksperiencash në planifikimin territorial dhe zhvillimin e “fshatrave model”. Në një qasje pragmatike dhe të balancuar, bashkëpunimi mund të ndërtohet mbi interesa reciproke ekonomike, duke respektuar kornizat rregullatore europiane dhe prioritetet kombëtare të zhvillimit.

Në këtë mënyrë, zhvillimi rural nuk mbetet thjesht një çështje e brendshme kineze, por shndërron në një platformë dialogu ekonomik dhe teknologjik ndërmjet Azisë dhe Europës, ku Shqipëria mund të pozicionohet si urë bashkëpunimi.

# Strategjia e Kinës për mirëqenie dhe prosperitetit të përbashkët



Një pamje e jashtme e Zyrës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në Gjenevë, Zvicër. /Foto nga Xinhua

**Dr. Marsela Musabelliu**

**“Kafshatë që s’kapërdihet asht, or vlla, mjerimi...”** Migjeni e ndjente dhe e njihnte mirë varfërinë, ai përshkruante dhe e përjetonte. Shumë vende vazhdojnë të përjetojnë atë kafshatë që s’kapërdihet dot. Ndër shekuj, individë e kombe e kanë ëndërruar zhdukjen e kësaj plage shoqërore. Sipas Divizionit të Statistikave të Kombeve të Bashkuara në vitin 2026 rreth 808 milionë njerëz jetojnë në varfëri ekstreme - nga vlerësimi i mëparshëm prej 677

milione - që përfaqëson 9.9% të popullsisë së botës, ose 1 në 10 persona. Zhdukja e varfërisë ekstreme deri në vitin 2030 duket shumë e pamundur. Mjerimi s’don mëshirë, por don vetëm të drejtë, vazhdonte Migjeni. Por ku gjendet kjo e drejtë? – Përgjigjja është sa e thjeshtë aq edhe e komplikuar: në drejtimin politik të një vendi. Nëse nuk ka politika të drejta për mbrojtjen e klasave shoqërore që janë më vulnerabël ndaj mjerimit, situata nuk ndryshon asnjëherë. Rrugëtimi i Kinës për të eliminuar varfërinë dhe për të rritur mirëqenien e njerëzve është një

histori mbresëlënëse suksesi. Detyra kolosale për t’i dhënë fund një herë e përgjithmonë varfërisë ekstreme u bë qëllimi parësor i administratës shtetërore nën drejtimin e Xi Jinping. Që në fund të vitit 2012 qeveria filloi të aplikojë metoda të paracaktuara të zbutjes së varfërisë dhe nisi të implementojë politikat e synuara ad hoc të lehtësimit të varfërisë duke adresuar shkaqet madhorë të saj duke investuar miliarda për këtë kauzë. Qeveria ka premtuar se mrekullia ekonomike do të ndryshonte fatin e të gjithë kinezëve, pa asnjë përjashtim - dhe fushata kundër



Një panair rrushi në Turpan, Rajoni Autonom Xinjiang-Ujgur i Kinës Veriperëndimore, gusht 2024./Foto nga Xinhua

varfërisë ka qenë prioritet për lidërshtipin kinez. Me slloganin “Në marshimin drejt prosperitetit të përbashkët, askush nuk do të mbetet pas” - vetëm në një dekadë më shumë se 100 milion njerëz e kapërcyen varfërinë ekstreme në Kinë. Por puna nuk ka mbaruar, në 2026 ka ende shumë objektiva të cilat shpal-

len në Planin e 15-të Pesëvjeçar të Kinës (2026-2030) me prioritet “Sigurimi dhe Përmirësimi i Mirëqenies Publike dhe Promovimi i Prosperitetit të Përbashkët për të Gjithë”

**Pesë vitet e ardhshme në agjendën zhvillimore të Kinës**  
Rekomandimet e Komitetit Qen-

dror të PKK-së për Formulimin e Planit të 15-të Pesëvjeçar për Zhvillimin Ekonomik dhe Social Kombëtar, u bënë publike më 23 tetor 2025. Në mars 2026, ky plan pritet të shqyrtohet dhe të aprovohet.

Në seksionin dedikuar prioritetëve zhvillimore, shënohet se përmbushja e aspiratave të njerëzve për një jetë më të mirë është qëllimi i pandryshueshëm i modernizimit kinez. Në përputhje me parimin e të bërit gjithçka brenda mundësive, duhet të sigurohet që shërbimet publike të jenë gjithëpërfshirëse, të plotësojnë nevojat thelbësore dhe të ofrojnë mbështetje për ata që kanë më shumë nevojë, si dhe të punohet për zgjidhjen e vështirësive dhe problemeve urgjente që shqetësojnë më së shumti



**Qeveria ka premtuar se mrekullia ekonomike do të ndryshonte fatin e të gjithë kinezëve, pa asnjë përjashtim - dhe fushata kundër varfërisë ka qenë prioritet për lidërshtipin kinez. Me slloganin “Në marshimin drejt prosperitetit të përbashkët, askush nuk do të mbetet pas” - vetëm në një dekadë më shumë se 100 milion njerëz e kapërcyen varfërinë ekstreme në Kinë.**

qytetarët. Kanalet e mobilitetit social duhet të mbeten të hapura dhe standardet e jetesës duhet të përmirësohen më tej.

**Promovimi i punësimit të plotë me cilësi të lartë:** Këtu vendoset prioriteti në avancimin e strategjisë së punësimit, duke krijuar një bashkëpunim më të ngushtë midis industrisë dhe tregut të punës. Planifikimi synon të krijojë vende pune dhe profesione të reja, dhe të ndihmojë kompanitë të mbajnë pagat të balancuara dhe të rrisin numrin e punonjësve. Gjithashtu, qeveria duhet të përmirësojë mënyrën se si përputhen nevojat e punës me aftësitë e njerëzve, të përmirësojë sistemin e trajnimit profesional gjatë gjithë jetës dhe të informojë publikun për mundësitë e karrierës dhe rekrutimit, me qëllim të adresimit të sfidave strukturore të tregut të punës.

**Përmirësimi i sistemit të shpërndarjes së të ardhurave:** kjo është një temë e nxehtë në të gjithë botën, por jo në Kinë. Krahas ekzistencës së formave të shumta të shpërndarjes, do të punohet për rritjen e peshës së të ardhurave personale në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare. Qëllimi është të përmirësohet mënyra se si paguhen njerëzit dhe shpërndahen fitimet, duke u bazuar tek puna dhe aftësitë e secilit. Po ashtu, duhet të përmirësohet mënyra e përcaktimit të pagave, duke siguruar që rritja e tyre të jetë e qëndrueshme. Duhet të vendosen rregulla për negociatat kolektive, të rishikohen ato minimale dhe të udhëzohen kompanitë për shpërndarjen e drejtë. Do të përdoren mënyra të



Banorët që janë nxjerrë nga varfëria mbledhin specia djegës pranë një vendi zhvendosjeje, Distrikti Qianjiang, Bashkia Chongqing, gusht 2021. / Foto nga VCG

ndryshme për të rritur të ardhurat nga prona e njerëzve dhe të bëjë rishpërndarje përmes taksave, sigurimeve shoqërore dhe pagesave të ndihmës.

**Zhvillimi i arsimit që pëmbush pritjet e njerëzve,** edhe kjo shumë e rëndësishme. Programet kombinojnë studimet politike në shkollë me përvojën praktike në shoqëri dhe forcojnë arsimin fizik, estetik dhe aftësitë praktike të punës. Burimet arsimore po shpërndahen më mirë, duke u fokusuar më shumë tek zonat urbane ku ka rritje të numrit të nxënësve. Burime shtesë po dërgohen tek shkollat e mesme, dhe programet për nxënës me nevoja speciale dhe të veçanta po menaxhohen më

mirë. Arsimi i lartë po zhvillohet duke rritur regjistrimet në programe universitare cilësore. Kapacitetet e shkollave profesionale po zgjerohen dhe kolegjet profesionale me karakteristika të veçanta po zhvillohen. Arsimi privat po udhëzohet dhe po rritet hapja e tij me standarde të larta. Bashkëpunimi mes shkollës, familjes dhe shoqërisë po forcohet, transformimi digjital në arsim po përparon dhe shërbimet publike po përmirësohen për të mbështetur mësimin gjatë gjithë jetës.

**Përmirësimi i sistemit të sigurimeve shoqërore:** Do të punohet më shumë për të përmirësuar dhe zbatuar një sistem kombëtar të unifikuar për sigurimin e



Shtëpitë e reja të fshatarëve të zhvendosur janë të vendosura midis kodrave dhe pemëve të gjelbërta, Qyteti Xinyu, Provinca Jiangxi e Kinës Lindore, gusht 2022. / Foto nga VCG

moshës së tretë. Sistemi i ndër-tuar me shtresa dhe nivele të ndryshme do të rrisë gradualisht përfitimet për banorët ruralë. Po ashtu, fokusi vendoset në përmirësimin i këtij sistemi duke menaxhuar më mirë fondet dhe duke rregulluar prokurimin e barnave, pagesat dhe përdorimin e fondeve të tepërta. Kina do të investojë gjithashtu në sistemin e menaxhimit të fondeve të sigurimeve shoqërore, duke përdorur pjesë të kapitalit shtetëror për të mbushur fondet dhe duke garantuar që këto fonde të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta.

**Promovimi i zhvillimit me cilësi të lartë në sektorin e pasurive të paluajtshme:** Kina do të përshpejtojë kultivimin e një modeli të ri zhvillimi për sektorin e pasurive të paluajtshme dhe të përmirësojë më tej sistemet bazë për zhvillimin, financimin dhe shitjen e bane-save. Duhet të përmirësohet furnizimi me banesa të subven-

cionuara nga shteti për të përm-bushur nevojat themelore të stre-himit të punëtorëve urbanë dhe familjeve në vështirësi.

**Avancimi i Iniciativës për Kinë të Shëndetshme:** Kina po ndjek një strategji që vendos shëndetin e popullsisë në qendër të prioritetëve shtetërorë. Synimi është të rritet jetëgjatësia dhe të përmirësohet shëndeti i përgjithshëm. Po forcohen kapacitetet e shëndetit publik, kontrol-

li i sëmundjeve dhe parandalimi i infeksioneve kryesore. Shërbimet mjekësore, sigurimet shëndetësore dhe sektori farmaceutik po menaxhohen më mirë, me diagnostikim dhe trajtim të shkallëzuar. Reformat në spitale, personel, tarifa dhe shpërblyme po sigurojnë që t'u shërbejnë më mirë qytetarëve. Po ofrohet mbështetje më e madhe për institucionet mjekësore në qark, rreth dhe komunitet. Shërbimet e komunitetit po



Studentët e Kolegjit Profesional të Industrisë së Lehtë Quanzhou po kryejnë trajnime pune nën drejtimin e mentorëve të tyre të biznesit, në Provincën Fujian, Kinë, maj 2024. / Foto nga CFP



Nxënësit shikojnë një shfaqje me qen robotë në një shkollë të mesme në Meishan, Provinca Sichuan e Kinës Jugperëndimore, shkurt 2025. /Foto nga CFP

përmirësohen dhe teknologjitë digjitale po përdoren për të rritur cilësinë e kujdesit.

**Promovimi i zhvillimit të “popullsisë me cilësi të lartë”:** Është ndërtuar dhe do të modernizohet më tej në këtë plan, një sistem gjithëpërfshirës që ofron shërbime për njerëzit gjatë gjithë jetës. Qeveria inkurajon qëndrime pozitive ndaj martesës dhe lindjes së fëmijëve, përmirëson politikat dhe stimujt për rritjen e lindshmërisë dhe ul kostot e lindjes, prindërimit dhe arsimimit përmes subvencioneve dhe lehtësimeve tatimore. Sistemi i sigurimit të lindjes dhe leja prindërore përmirësohen, ndërsa shërbimet për gratë gjatë shtatzënisë dhe kujdesi ndaj fëmijëve bëhen më cilësorë. Do të zbatohen skema për kujdes afatgjatë, përmirësohet kujdesi për të moshuarit me aftësi të kufizuara dhe zgjerohen shërbimet e rehabilitimit dhe kujdesit paliativ. Moshja e daljes në pension rritet gradualisht, ndërsa politi-

kat e punësimit dhe sigurimeve përshtaten për të shfrytëzuar potencialin e të moshuarve.

**Sigurimi i aksesit më të barabartë në shërbimet publike bazë:** do të vendosen standarde të detajuara për të siguruar që të gjithë qytetarët kanë akses të barabartë në shërbimet publike bazë. Përcaktohen objektivat, mënyrat dhe masat për realizimin e këtij aksesit. Shërbimet publike drejtohen më shumë drejt komuniteteve, zonave rurale, rajoneve të largëta dhe personave në nevojë. Do të zhvillohet më tej furnizimi i shërbimeve bazë në nivel qarku dhe përmirësohen mekanizmat afatgjatë për të siguruar që të jenë gjithmonë të mjaftueshme. Reforma e institucioneve publike thellohet në të gjitha aspektet për të garantuar shërbime më efikase, gjithëpërfshirëse dhe të drejta për qytetarët.

Së fundmi, ky plan është një shembull i spikatur i vizionit shtetëror, ku politika sociale,

ekonomike dhe arsimore ndërthuren për të ndërtuar një shoqëri më të barabartë dhe më të zhvilluar. Nga fokusi te punësimi, te shpërndarja e drejtë e të ardhurave, arsimit që plotëson nevojat e njerëzve, sigurimet shoqërore të forta, strehimi i përballueshëm, shëndeti i popullsisë, etj, të gjitha tregojnë angazhimin e qeverisë për të promovuar prosperitetin për të gjithë qytetarët. Ashtu si u përmbushën objektivat e Planit Pesëvjeçar të kaluar, këto objektiva, edhe pse shumë ambicioze deri në 2030, ka shumë gjasa të bëhen realitet. Duke vendosur standarde të larta në çdo aspekt dhe duke përballuar sfidat e sotme me pragmatizëm, Kina po shndërron mundësitë e reja në zhvillim për një shoqëri moderne, inovative dhe më egalitare. Ky është një model i qeverisjes që nuk lë askënd pas, ndërsa afirmon fuqinë dhe vendosmërinë e shtetit për të udhëhequr shoqërinë drejt një të ardhmeje të begatë dhe të drejtë.

# Mundësitë i tejkalojnë sfidat në bashkëpunimin e gjelbër Kinë-BE



Foto nga VCG

Prof. Dr. Kong Tianping <sup>\*1</sup>  
Prof. Yang Danping <sup>\*2</sup>

**P**lani pesëvjeçar i zhvillimit i publikuar së fundmi nga qeveria kineze, e vendos në mënyrë të qartë transformimin e gjelbër në thelb të zhvillimit kombëtar. Ky plan thekson se zhvillimi i gjelbër është një rrugë kyçe drejt modernizimit. BE është gjithashtu e përkushtuar ndaj qëllimeve të saj të transformimit të gjelbër. Duke parë përpara, ekziston një hapësirë e gjerë për bashkëpunime midis Kinës dhe BE-së në fushën e zhvillimit të gjelbër, duke ofruar mundësi të konsiderueshme për të arritur

qëllimet e përbashkëta klimatike dhe mjedisore.

Së pari, si Kina ashtu edhe Evropa janë të përkushtuara ndaj transformimit të gjelbër. Zhvillimi i gjelbër ka qenë prej kohësh një komponent i rëndësishëm i filozofisë së re

të zhvillimit. Në vitin 2020, Kina njoftoi qëllimin e saj për të arritur kulmin e karbonit deri në vitin 2030 dhe neutralitetin e karbonit deri në vitin 2060. Transformimi i gjelbër i Planit të 15-të Pesëvjeçar të propozuar nga Kina,

“

Zhvillimin Ekonomik dhe Social Kombëtar”, theksojnë në mënyrë të qartë përsheptimin e transformimit gjithëpërfshirës të gjelbër të zhvillimit ekonomik dhe social. Sugjerimet theksojnë përdorimin e arritjes së kulmit të karbonit dhe neutralitetit të karbonit, si një forcë lëvizëse për të promovuar në mënyrë sinergjike reduktimin e karbonit, reduktimin e ndotjes, zgjerimin e gjelbërimit dhe rritjen, duke forcuar kështu barrierën e sigurisë ekologjike dhe duke rritur vrullin e zhvillimit të gjelbër



Turbinat me erë në qytetin Pingliang, Provinca Gansu, Kinë Veriperëndimore, qershor, 2024. /Foto nga VCG

është në përputhje me atë të BE-së. “Sugjerimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës për Formulimin e Planit të 15-të Pesëvjeçar për Zhvillimin Ekonomik dhe Social Kombëtar”, theksojnë në mënyrë të qartë përshpejtimin e transformimit gjithëpërfshirës të gjelbër të zhvillimit ekonomik dhe social. Sugjerimet theksojnë përdorimin e arritjes së kulmit të karbonit

dhe neutralitetit të karbonit, si një forcë lëvizëse për të promovuar në mënyrë sinergjike reduktimin e karbonit, reduktimin e ndotjes, zgjerimin e gjelbërimit dhe rritjen, duke forcuar kështu barrierën e sigurisë ekologjike dhe duke rritur vrullin e zhvillimit të gjelbër. Në vitin 2019, Komisioni Evropian lançoi Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe vendosi një objektiv për arritjen

e neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050, duke e bërë Evropën kontinentin e parë që arrin neutralitetin klimatik deri atëherë.

Së dyti, bashkëpunimi i gjelbër Kinë-BE është shumë përplotësues. Si pasojë e ndryshimeve në strukturat e energjisë, por dhe niveleve të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe social midis Kinës dhe Evropës, Kina është në fazën e kulmit të karbonit para vitit 2030, ndërsa Evropa është tashmë në fazën e neutralitetit të karbonit. Fazat e ndryshme të transformimit të gjelbër në të cilat janë të pranishme Kina dhe BE, krijojnë mundësi për bashkëpunim dypalësh.

Kina dhe BE janë partnerët e dytë më të mëdhenj tregtarë të njëra-tjetrës. Në vitin 2025, eksportet e gjelbra të Kinës në BE u rritën ndjeshëm, me eksportet e turbinave me erë që u rritën me 65.9% nga viti në vit dhe eksportet e pajisjeve elektrike si grumbuj karikimi DC dhe bateritë e ruajtjes së energjisë që u rritën me 25.4%. Ndërkohë, importet e Kinës të produkteve të riciklueshme nga BE u rritën me 18.9%.

**Kina dhe BE janë partnerët e dytë më të mëdhenj tregtarë të njëra-tjetrës. Në vitin 2025, eksportet e gjelbra të Kinës në BE u rritën ndjeshëm, me eksportet e turbinave me erë që u rritën me 65.9% nga viti në vit dhe eksportet e pajisjeve elektrike si grumbuj karikimi DC dhe bateritë e ruajtjes së energjisë që u rritën me 25.4%. Ndërkohë, importet e Kinës të produkteve të riciklueshme nga BE u rritën me 18.9%.**



Punëtorët e fabrikës së automjeteve me energji të re akordojnë makina në linjën e prodhimit, Jinhua, Provinca Zhejiang, Kinë, janar 2026. /VCG

u rritën me 65.9% nga viti në vit dhe eksportet e pajisjeve elektrike si grumbuj karikimi DC dhe bateritë e ruajtjes së energjisë që u rritën me 25.4%. Ndërkohë, importet e Kinës të produkteve të riciklueshme nga BE u rritën me 18.9%.

Kina dhe BE kanë secila përparësi në zinxhirin e furnizimit me energji të pastër. Prodhimi fotovoltaiik i Kinës është lider në botë, ndërsa Evropa ka përparësi në zhvillimin dhe prodhimin e energjisë së hidrogjenit. Kina shkëlqen në prodhimin në shkallë të gjerë por edhe në zhvillimin dhe promovimin e teknologjive të gjelbra, duke formuar një zinxhir industrial të gjelbër relativisht të plotë. Evropa është pioniere në transformimin e gjelbër dhe me karbon të ulët, duke shkëlqyer

në konceptet, normat, standardet, rregulloret dhe qeverisjen e gjelbër, madje ka formuar sistemin më të madh dhe më



*Kina dhe BE kanë secila përparësi në zinxhirin e furnizimit me energji të pastër. Prodhimi fotovoltaiik i Kinës është lider në botë, ndërsa Evropa ka përparësi në zhvillimin dhe prodhimin e energjisë së hidrogjenit. Kina shkëlqen në prodhimin në shkallë të gjerë por edhe në zhvillimin dhe promovimin e teknologjive të gjelbra, duke formuar një zinxhir industrial të gjelbër relativisht të plotë.*



të pjekur në botë të tregimit të emetimeve të karbonit, si edhe një sistem të zhvilluar të financimit të gjelbër.

Së treti, si Kina ashtu edhe Evropa kanë gatishmërinë për të promovuar bashkëpunimin e gjelbër. Vitet e fundit, Kina dhe BE kanë mbajtur komunikim dhe koordinim të ngushtë mbi çështjet e gjelbra. Ato kanë krijuar disa mekanizma bashkëpunimi, duke përfshirë Dialogun Ministror mbi Politikën Mjedisore, Dialogun Ministror mbi Ndryshimet Klimatike, Dialogun e Politikave të Tregtimit të Emetimeve të Karbonit, Dialogun e Energjisë Kinë-BE, Platformën e Bashkëpunimit të Energjisë Kinë-BE, Mekanizmin e Koordinimit Dypalësh mbi Zbatimin dhe Qeverisjen e Pyjeve si dhe Dialogun e Nivelit të Lartë mbi Ekonominë Rrethore.



Sistemi inteligjent i monitorimit në Parkun Kombëtar Pyjor Laoshan në Nanjing, Provinca Jiangsu e Kinës Lindore. / Foto nga CMG

Në korrik 2025, udhëheqësit e Kinës dhe BE-së lëshuan një deklaratë të përbashkët mbi adresimin e ndryshimeve klimatike. Deklarata theksoi se partneriteti i gjelbër Kinë-BE është një komponent i rëndësishëm i partneritetit të përgjithshëm Kinë-BE, zhvillimi i gjelbër është një tipar dallues i bashkëpunimit Kinë-BE, dhe se të dyja palët kanë një themel të fortë dhe një hapësirë të gjerë për bashkëpunim në fushën e transformimit të gjelbër. Përballë një situatë ndërkombëtare komplekse dhe të paqëndrueshme, ekziston një potencial i madh për bashkëpunimin e gjelbër Kinë-BE.

**1. Forcimi i Dialogut për Politikën e Gjelbra.** Tranzicioni i gjelbër përfshin aspekte të shumta, si tregjet, industrinë, teknologjitë dhe standardet

duke u bërë një nga tranzicionet më komplekse në historinë e njerëzimit. Ai nuk është i nevojshëm vetëm për zhvil-



***Rritja e temperaturave globale është thelbësore për mbijetesën e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik. Adresimi i ndryshimit të klimës kërkon bashkëpunim të gjerë ndërkombëtar. Në vitin 2015, Kina dhe BE nënshkruan Deklaratën e Përbashkët BE-Kinë mbi Ndryshimin e Klimës. Në vitin 2020, Kina dhe BE krijuan një mekanizëm dialogu të nivelit të lartë mbi mjedisin dhe klimën.***



limin e brendshëm ekonomik dhe shoqëror, por edhe për adresimin e ndryshimeve globale klimatike. Bashkëpunimi midis Kinës dhe BE-së në tranzicionin e gjelbër, kërkon udhëzime politike të nivelit të lartë si dhe dialog politik midis zyrtarëve, ekspertëve dhe studiuesve përkatës nga të dyja palët. Në një botë të pasigurt dhe të rrezikshme, komunikimi, shkëmbimi dhe dialogu midis Kinës dhe BE-së janë të paçmueshme.

**2. Thellimi i Bashkëpunimit në Industrinë e Gjelbra.** Tranzicioni i gjelbër përfshin transformimin e strukturave industriale, veçanërisht zhvillimin e industrive të gjelbra. Komisioni Kombëtar i Zhvillimit dhe Reformës (NDRC) ka publikuar një katalog udhëzimesh për transformimin e indus-



Një pamje e qytetit Wuhu në provincën Anhui, Kinën Lindore, korrik, 2025. / Foto nga VCG

trive të gjelbra dhe me karbon të ulët, duke udhëhequr zhvillimin e tyre. Kina inkurajon ndërmarrjet të bëjnë investime të gjelbra jashtë vendit dhe të përshpejtojnë integrimin me zinxhirin global industrial të gjelbër. Prodhimi i produkteve të gjelbra në Kinë, siç janë pajisjet fotovoltaike, bateritë litium-jon, pajisjet me efikasitet të lartë për kursimin e energjisë dhe automjetet e reja të energjisë, vazhdon të rritet, duke i dhënë asaj një avantazh konkurrues ndërkombëtar. CATL ka ndërtuar fabrika baterish në Gjermani, Hungari dhe Spanjë. Guoxuan High-Tech është partnerizuar me një kompani sllovake për të ndërtuar një fabrikë baterish për automjete elektrike në Šulani. Kohët e fundit, Sungrow Power njoftoi se do të investojë në një fabrikë në Poloni për të prodhuar invertorë fotovoltaike

dhe sisteme ruajtjeje energjie. Prodhuesi kinez i automjeteve elektrike BYD po ndërton një fabrikë makinash pasagjerësh në Hungari, ndërsa Chery është partnerizuar me Ebro të Spanjës për të prodhuar automjete elektrike. Hyrja e kompanive kineze në Evropë ndihmon në përmirësimin e zinxhirit industrial evropian dhe stabilizimin e zinxhirit të furnizimit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal dhe duke krijuar vende pune. Si Kina ashtu edhe Evropa duhet të eksplorojnë potencialin për bashkëpunim në industrinë e gjelbra për të arritur përfitim të ndërsjellë dhe rezultate të favorshme për të dyja palët.

**3. Promovimi i Bashkëpunimit për Teknologjinë e Gjelbër.** Kina ka përparësi në teknologji të tilla si fotovoltaiket diellorë, turbinat me erë, bateritë, au-

tomjetet elektrike dhe pompat e nxehtësisë. Evropa gjithashtu zotëron teknologji të përparura në fushën e transformimit të gjelbër. Potenciali për bashkëpunimin sino-evropian në teknologjinë e gjelbër është i jashtëzakonshëm. Në prill të vitit 2025, Kina dhe BE-ja nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi mbi Bashkëpunimin në Teknologjinë e Gjelbër, duke planifikuar të investojnë së bashku 15 miliardë euro gjatë tre viteve në gjashtë fusha kryesore, duke përfshirë energjinë e hidrogjenit, ruajtjen e energjisë dhe kapjen e karbonit, për të krijuar aleancën më të madhe transnacionale në botë për Kërkim dhe Zhvillim në teknologjinë e gjelbër. Bashkëpunimi shkencor dhe teknologjik midis Kinës dhe BE-së në fusha të tilla si energjia e pastër, tranzicioni energjetik, teknologjitë



Automjetet e reja me energji presin dërgesën në një terminal eksporti automobilash, Shangai, Kinë, janar 2026. / Foto nga VCG

me karbon të ulët, qeverisja e klimës, qeverisja mjedisore dhe riciklimi i burimeve, do të ndihmojë në promovimin e transformimit të gjelbër të të dy vendeve. Kina dhe BE-ja mund të krijojnë laboratorë dhe qendra të përbashkëta inovacioni për të çuar përpara projekte të përbashkëta të Kërkim-Zhvillimit të Gjelbër.

**4. Promovimi i Qeverisjes Globale të Klimës.** Ndryshimi i klimës është çështja më urgjente globale me të cilën përballet njerëzimi. Rritja e temperaturave globale është thelbësore për mbijetesën e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik. Adresimi i ndryshimit të klimës kërkon bashkëpunim të gjerë ndërkombëtar. Në vitin 2015, Kina dhe BE nënshkruan Deklaratën e Përbashkët

BE-Kinë mbi Ndryshimin e Klimës. Në vitin 2020, Kina dhe BE krijuan një mekanizëm dialogu të nivelit të lartë mbi mjedisin dhe klimën. Deklarata e Përbashkët e Udhëheqësve BE-Kinë e vitit 2025 mbi Adresimin e Ndryshimit të Klimës, zotohet të mbështesë pozicionin thelbësor të Konventës Kornizë të OKB-së mbi Ndryshimin e Klimës dhe Marrëveshjes së Parisit, të forcojë bashkëpunimin dypalësh në fusha të tilla si tranzicioni i energjisë, përshtatja ndaj klimës, kontrolli i emetimeve të metanit, tregjet e karbonit dhe teknologjitë e gjelbra dhe me karbon të ulët, si dhe të promovojë së bashku proceset e tyre përkatëse të transformimit të gjelbër dhe me karbon të ulët. Pasi SHBA-të u tërhoqën përsëri nga Marrëveshja e Parisit, Kina dhe BE janë bërë

forcat kryesore në adresimin e ndryshimeve klimatike dhe promovimin e transformimit të gjelbër në nivel global. Partneriteti i gjelbër Kinë-BE injekton siguri në qeverisjen globale të klimës, duke demonstruar angazhimin e Kinës dhe BE-së për qeverisjen globale të klimës. Kina dhe BE-ja mund të eksplorojnë bashkëpunimin për transformimin e gjelbër me palë të treta në nivel global, të kultivojnë nyje të reja bashkëpunimi, të shfrytëzojnë avantazhet e tyre përkatëse si dhe të promovojnë uljen globale të emetimeve të ulëta të karbonit.

Promovimi i bashkëpunimit të gjelbër Kinë-BE nuk është pa sfida. Bashkëpunimi i gjelbër sino-evropian ndikohet nga ndryshimet gjeopolitike. Konkurrenca midis fuqive të mëdha po riformëson pei-

zazhin ekonomik global, duke çuar në një rënie të besimit midis aktorëve kryesorë ndërkombëtarë. Në Forumin e Davosit të këtij viti, bashkëpunimi i gjelbër sino-evropian madje u bë shënjestër e fushatave injorante të shpifjes nga presidenti i një fuqie të madhe. Konkurrenca midis fuqive të mëdha ka nxitur gjithashtu konkurrencën në sektorin e gjelbër, me ekspertë nga Këshilli i së Ardhmes Globale që paralajmërojnë se “sfida aktuale është të parandalohet që ‘konkurrenca e gjelbër’ të evoluojë në merkantilizëm të gjelbër - një garë me shumë zero subvencionesh, tarifash dhe grumbullimi teknologjik”. Evropa po përballet gjithashtu me faktorë që po dëmtojnë bashkëpunimin e gjelbër sino-evropian. Në dhjetor 2025, Komisioni Evropian hoqi dorë nga ndalimi i tij për shitjen e makinave me benzinë nga viti 2035, një hap prapa në transformimin e gjelbër të Evropës. Evropa e sheh Kinën si partnere, konkurrente dhe kundërshtarë sistematike, një pozicionim i trefishtë që në mënyrë të pashmangshme ndikon në qëndrimin e saj ndaj bashkëpunimit sino-evropian. Ndërsa gjithnjë e më shumë udhëheqës evropianë po fillojnë të pranojnë realitetin se bashkëpunimi sino-evropian është më i rëndësishëm se konkurrenca, Brukseli mbetet kokëfortësisht i rrënjosur. Ndërvarësia, dikur e parë si një mundësi, tani shihet si një kërcënim. “Heqja e riskut” nga BE-ja ndaj Kinës, padyshim që do të ndikojë në bashkëpunimin



***Rritja e proteksionizmit tregtar në Evropë është shqetësuese. Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit i BE-së (CBAM), i zbatuar më 1 janar 2026, vendos një vlerë parazgjedhjeje dukshëm më të lartë për intensitetin e emetimeve të karbonit të produkteve kineze, duke shfaqur karakteristika të qarta proteksioniste.***



e gjelbër sino-evropian. Evropa e ka një nevojë reale bashkëpunimin e gjelbër me Kinën, ashtu edhe shqetësimet për mbështetjen e tepërt nga Kina. Evropa thekson sovranitetin teknologjik dhe zvogëlon mbështetjen e saj në zinxhirët e furnizimit kinez.

Rritja e proteksionizmit tregtar në Evropë është shqetësuese. Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit i BE-së (CBAM), i zbatuar më 1 janar 2026, vendos një vlerë parazgjedhjeje dukshëm më të lartë për intensitetin e emetimeve të karbonit të produkteve kineze,

duke shfaqur karakteristika të qarta proteksioniste. BE-ja përdor CBAM-in për të ngritur “barriera të gjelbra” dhe shpesh zbaton masa të synuara mbrojtëse tregtare, të tilla si planet për të imponuar kërkesa minimale “Prodhuar në Evropë” në prokurimin publik të teknologjive kryesore të gjelbra. Shkurt, një rritje e proteksionizmit do të hedhë në mënyrë të pashmangshme një hije mbi bashkëpunimin e gjelbër kino-evropian. Megjithatë, Kina mbetet e përkushtuar ndaj hapjes në nivel të lartë në Planin e saj të 15-të Pesëvjeçar dhe shpreson që Evropa do të vazhdojë të jetë një partnere e qëndrueshme.

Bashkëpunimi i gjelbër kino-evropian po përballet me shumë sfida, por momenti për transformimin e gjelbër mbetet, vullneti politik për bashkëpunim të gjelbër vazhdon dhe as Kina dhe as BE nuk e kanë braktisur përgjegjësinë e tyre ndërkombëtare për të adresuar ndryshimet klimatike. Në një botë të trazuar, për sa kohë që të dyja palët i përmbahen qëllimeve të tyre fillestare të bashkëpunimit dhe kërkojnë përfitim të ndërsjellë, partneriteti i gjelbër sino-evropian mund të bëhet një model i bashkëpunimit ndërkombëtar.

\*1 *Studiues, Instituti i Studimeve Evropiane, Akademia Kineze e Shkencave Sociale*

\*2 *Zëvendësdekane, Instituti i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar midis Evropës Qendrore dhe Lindore, Universiteti Ningbo.*

# Kina, zhvillimi i gjelbër dhe disa mësimet për shqipërinë



Fshati Tangzhuang në qytetin Nantong, Provinca Jiangsu e Kinës Lindore, maj, 2025. / Foto nga VCG

## Alqi Kaçiko\*

**S**i pjesë e një grupi gazetarrësh nga Evropa Lindore dhe Juglindore, vizitova Kinën në vitin 2009, në kuadër të 60-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis vendeve tona dhe Kinës. Në atë kohë, ishte në modë të lexoje tituj në shtypin ndërkombëtar për ndotjen shqetësuese të ajrit në qytete të mëdha si Pekini dhe gjatë. Ndërkohë, përpara Lojërave Olimpikë të Pekinit në vitin

2008, qeveria kineze ishte aq e shqetësuar për ndotjen, sa vendosi kufizime të përkohshme për qarkullimin e makinave, mbylli fabrika dhe ndaloi punimet në disa kantiere ndërtimi. Masat funksionuan dhe një studim zbuloi më vonë se nivelet e ndotjes së ajrit ranë me 30% gjatë periudhës kur ishin në fuqi kufizimet e përkohshme olimpikë.

Në fakt, vetëm një vit pas kësaj nisme, ne pamë një Pekin krejtësisht ndryshe nga ai për të cilin kishim dëgjuar; për një qytet shumëmilionësh, ajri

ishte shumë i pastër se ai i Tiranës. Në vitin 2013, qeveria kineze filloi të zbatonte një plan më të përgjithshëm veprimi për ajrin e pastër. Që atëherë, Kina ka arritur një përmirësim dramatik të cilësisë së ajrit.

Në ditët e sotme, Kina ka bërë përpertime aq mbresëlënëse në zhvillimin e gjelbër, sa është shndërruar në një lider botëror dhe në një shembull për t'u ndjekur. Planet ambicioze të udhëheqjes kineze në këtë drejtim ilustrohen me detaje në Rekomandimet e



Një park eolik në provincën Hainan të Kinës Jugore, tetor 2025. / Foto nga VCG

Komitetit Qendror të PKK-së për Hartimin e Planit të 15-të Pesëvjeçar për Zhvillimin Ekonomik dhe Social Kombëtar. Ato përfshijnë disa pika kyçe, si lufta kundër ndotjes, përshtetimi i kalimit drejt një sistemi të ri energjetik, kontrolli i emetimeve të karbonit dhe promovimi i praktikave dhe stileve të jetesës miqësore me mjedisin.

Që Kina është e aftë të ndër-marrë iniciativa gjigante, mjafton të përmendet se në nëntor 2024 vendi përfundoi një fushatë 46-vjeçare për të “bllokuar” përmes një operacioni masiv pyllëzimi, shkretëtirën e saj më të madhe. Si rezultat, pas një këmbënguljeje afatgjatë “gabo, mëso dhe përmirëso”, u përfundua një brez i gjelbër rreth 3,000 km përreth Shkretëtirës Taklamakan, në rajonin veriperëndimor të Xinjiang-ut, nën projektin e njohur si Muri i Madh i Gjelbër. Janë mbjellë më shumë se

30 milionë hektarë pemë, duke rikuperuar zona të mëdha toke shkretinore. Por kjo ndërmar-rje e paimagjinueshme nuk përfundon këtu.

Vendi synon arritje të reja në këtë fazë vendimtare të programit kombëtar të brezave mbrojtës pyjorë në veriperëndim, veri dhe verilindje të Kinës, si dhe forcimin e mburojave ekologjike në rajone si rrafshnalta Qinghai-Tibet. Në rekomandimet për Planin e

15-të Pesëvjeçar kërkohet vijimi i programeve masive të gjelbërimit, vëmendje më e madhe ndaj trajtimit të ndotjes në burim, me moton “Të mbajmë qiellin blu, ujërat të kthjellëta dhe tokën të pastër.” Gjithashtu kërkohet aktivizimi i nismave për trajtimin e gjithanshëm të mbetjeve të ngurta si dhe përmirësimi i sistemeve të standardeve mjedisore, monitorimit dhe vlerësimit.

Kina vijon të thyejë rekorde



Panele fotovoltaike në qytetin Bozhou, Provinca Anhui, Kina Lindore, gusht 2024. / Foto nga VCG



Pyll mangrove në Rezervatin Natyror Kombëtar Dongzhaigang në provincën Hainan të Kinës Jugore. / Foto nga VCG

me rritjen e vazhdueshme të prodhimit të energjisë diellore dhe asaj të erës. Deri në qershor 2025, kapaciteti i instaluar i energjisë fotovoltaike diellore i vendit ka kaluar për herë të parë 1,000 GW, ekuivalente me gjysmën e kapacitetit total të instaluar diellor në botë. Sasia e energjisë diellore dhe asaj eolike në ndërtim në Kinë është tani pothuajse dyfish i pjesës tjetër të botës së bashku. Me fjalë të tjera, Kina është transformuar në një kontribuuese kyçe për një planet më

të gjelbër. Edhe në Rekomandimet e reja synohet rritja e peshës së energjisë së re në furnizimin total me energji, përparimi i tranzicionit sistematik nga lëndët djegëse fosile drejt alternativave të sigurta dhe të besueshme, si dhe ndërtimi i një sistemi të ri të energjisë elektrike.

Njëkohësisht, promovohet përdorimi i pastër dhe efikas i lëndëve djegëse fosile, me vazhdimin e modernizimit të termocentraleve me qymyr dhe heqjen graduale të për-

dorimit të qymyrit në sektorët jo-industrialë.

Sipas të dhënave të janarit 2026, kompania kineze BYD ka tejkaluar Teslën si shitësi më i madh në botë i automjeteve elektrike (EV), duke shënuar herën e parë që e kalon rivalin amerikan në shitjet vjetore. Zgjerimi i shpejtë i kompanisë me seli në Shenzhen ka ndodhur veçanërisht në Amerikën Latine, Azinë Juglindore dhe pjesë të Evropës.

Sot, vendi synon të zhvillojë burime të shpërndara energjie dhe të ndërtojë fabrika dhe parqe industriale me zero karbon. Ndër rekomandimet për Planin e 15-të Pesëvjeçar spikat zgjerimi i mbulimit të Bursës së Tregtimit të Emisioneve të Karbonit në Kinë dhe krijimi më i shpejtë i një Tregu Kombëtar Vullnetar për Reduktimin e Emetimeve të Gazrave Serrë.

Njëkohësisht, promovohet menaxhimi mjedisor sipas veçorive rajonale dhe tranzicionet e gjelbra e me karbon të ulët

**Sipas të dhënave të janarit 2026, kompania kineze BYD ka tejkaluar Teslën si shitësi më i madh në botë i automjeteve elektrike (EV), duke shënuar herën e parë që e kalon rivalin amerikan në shitjet vjetore. Zgjerimi i shpejtë i kompanisë me seli në Shenzhen ka ndodhur veçanërisht në Amerikën Latine, Azinë Juglindore dhe pjesë të Evropës.**



Automjetet e reja me energji po ngarkohen në Zibo, në provincën Shandong të Kinës Lindore, maj 2025. / Foto nga VCG

në industri, zhvillimin urban e rural, transport, energji dhe sektorë të tjerë kyç. Kërkohen përmirësime në sistemet e kontrollit të konsumit total të burimeve dhe ruajtjes gjithëpërfshirëse të tyre, ndërsa ndarja dhe riciklimi i mbetjeve duhet të përshpejtohen për të nxitur ekonominë qarkulluese.

Nga një lexim i Rekomandimeve të Komitetit Qendror të PKK-së për Hartimin e Planit të 15-të Pesëvjeçar për Zhvillimin Ekonomik dhe Social Kombëtar në fushën e zhvillimit të gjelbër, kupton vëmendjen që i është kushtuar çdo aspekti të këtij sektori kaq të gjerë dhe shumëplanësh. Dhe njëkohësisht sheh sesa më i thjeshtë do të kishte qenë zbatimi praktik dhe serioz i një sipërmarrjeje të tillë për vendin tonë.

Sepse problemi i ndotjes në Shqipëri është “sekreti ynë i përbashkët”. Pavarësisht faktit se vendi prodhon pothuajse tërësisht energji të gjelbër, falë

hidrocentraleve dhe instalimit në rritje të paneleve diellore, është fakt se Shqipëria ka ende shumë për të bërë në një gamë të gjerë sektorësh që lidhen me këtë fushë: nga lufta kundër erozionit përmes pyllëzimit, te menaxhimi i mbetjeve – ku ka pasur shumë pak produkt real dhe shumë skandale – ndotja mjedisore e shkaktuar nga makinat e vjetra me lëndë djegëse fosile dhe mbrojtja e lumenjve dhe deteve.

Në fund të fundit, zhvillimi i mëtejshëm dhe i qëndrueshëm i turizmit do të varet në masë të madhe nga një mjedis i pastër, energji e gjelbër dhe një stil jetese miqësor me natyrën. Në këtë drejtim, Shqipëria ka shumë për të mësuar nga përvoja dhe përparimi kinez. Por jo thjesht me retorikë.

Ajo që mungon në vendin tonë nuk janë fushatat boshe të “ndërgjegjësimit”, por mbështetja konkrete shtetërore

që do të promovonte zhvillimin e gjelbër në industri, turizëm, mjedis, transport, si dhe në jetën e përditshme. Në këtë drejtim, rekomandimet për Planin e 15-të Pesëvjeçar të Kinës orientojnë përpjekje të qëndrueshme për ndërtimin e zonave kombëtare eksperimentale për ruajtjen ekologjike, krijimin e zonave pilot nën Nismën “Kina e Bukur” dhe nxitjen e shembujve pozitivë të zhvillimit të gjelbër.

Gjithashtu Rekomandimet udhëzojnë politika fiskale, tatimore, financiare, investimi, çmimesh, shkencore e teknologjike dhe mjedisore që nxisin zhvillimin e gjelbër dhe me karbonv të ulët. Pikërisht këto dhe forma të tjera të mbështetjes shtetërore janë ato fusha për të cilat Shqipëria duhet të hedhë shumë më tepër se “një sy” nga përvoja kineze.

*\*Kryeredaktor i  
Albanian Daily News*

## Të nderuar lexues dhe ndjekës të **Argumentum.al**,

Që nga viti 2022, **Argumentum.al** vjen gjithashtu edhe në versionin e një Reviste të përmuajshme politike-diplomatike, e cila është e disponueshme për t'u shfletuar online.

Ky botim mujor ofron një përmbledhje të qartë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme, si në nivel vendi, ashtu edhe në rajon e botë. Gjithashtu, revista ofron analiza dhe opinione të thelluara mbi ngjarjet kryesore që kanë ndodhur gjatë muajit.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë. **Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj.

Në të njëjtën kohë **Argumentum.al** është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj. Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten **Argumentum.al** në shqip dhe anglisht!

*“Argumentum”, një proces intelektual ...*

Marjana DODA

Kryeredaktore



© 2026 Argumentum. Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Revista “Argumentum” nuk mund të riprodhohet  
në asnjë formë pa lejen me shkrim të botuesit.



**Adresa: Njësia bashkiake nr. 5, Rruga "Abdyl Frasheri", Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri**

**Tel: +355 (0) 68 82 01 720**

**Email: [redaksia.argumentum@gmail.com](mailto:redaksia.argumentum@gmail.com),  
[info@argumentum.al](mailto:info@argumentum.al)**

**NUIS/NIPT: L91415033Q**

**Twiter : [Argumentum\\_al](#)**

**Facebook: [argumentum.al](#)**

**Instagram: [argumentumnews](#)**

**© Argumentum. All rights reserved**